



PROKURIMI I “PËRLIGJUR” NË KOMUNAT E KOSOVËS:

raport i monitorimit të prokurimit publik në
komunat e Republikës së Kosovës

Prishtinë, nëntor 2019

PROKURIMI I “PËRLIGJUR” NË KOMUNAT E KOSOVËS:
raport i monitorimit të prokurimit publik në komunat e Republikës
së Kosovës

Autor: Albulena Nrecaj

Ekipi i hulumtuesve: Vedat Poterqoi, Samire Sahiti

Redaktorët: Betim Musliu, Ehat Miftaraj, Qëndrim Arifi

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e INPO-s dhe IKD-së.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Iniciativa për Progres – INPO dhe Institutit të Kosovës për Drejtësi – IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan.

Përkrahur nga:



Nëntor 2019

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	7
Përmbledhje ekzekutive.....	8
Metodologjia.....	11
Korniza ligjore vs praktika.....	13
Gjetjet kryesore në monitorimin e aktiviteteve të prokurimit publik	16
Gjetjet në aktivitetet e prokurimit në Drenas	18
Intervenimet emergjente	18
Furnizim me artikuj higjenik: Institucionet Komunale–Administrata, Arsimi dhe Shëndetësia	18
Gjetjet në aktivitetet e prokurimit në Deçan.....	19
Ndërtimi – Zgjerimi i rrugës R107 qendrore në Deçan (Ura e Demës–Carrabreg)	19
Asfaltimi i rrugëve në fshatin Irlznic.....	20
Gjetjet në aktivitetet e prokurimit në Gjilan	21
Pastrimi i objekteve komunale.....	21
Gjetjet në aktivitetet e prokurimit në Ferizaj	23
Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve në kuadër të Komunës së Ferizajt	23
Sigurimi fizik i objekteve në kuadër të Komunës së Ferizajt.....	26
Administrimi i profilin të kryetarit të komunës në rrjetet sociale	30
Gjetjet në aktivitetet e prokurimit në Junik.....	32
Mirëmbajtja dhe servisi i pajisjeve mjekësore.....	32
Hapja e rrugëve fushore në Komunën e Junikut	32
Gjetjet në aktivitetet e prokurimit në Klinë.....	33
Asfaltimi i Rrugëve lokale: Budisalc, Stup, Siqevë, Qeskov, Gjurgjevik i Vogël.....	33
Ndërtimi i Kanalizimeve: Ranoc–Leskoc, Dresnik, Dollc dhe në lagje të Klinës	34
Asfaltim i rrugëve: Dollovë, Grabanicë, Dush, Jellovc	35
Gjetjet në aktivitetet e prokurimit në Ranillug	36
Ndërtimi i sallës së fiskullturës për shkollën fillore “Trajko Periq” në Ropotovë të Madhe .	36
Furnizim me ushqime dhe produkte higjienike	38
Gjetjet në aktivitetet e prokurimit në Malishevë.....	39
Renovimi i objekteve shkollore, çerdhes publike dhe sallës së sportit në Malishevë	39
Gjetjet në aktivitetet e prokurimit në Mitrovicë të Jugut	40
Ndërtimi dhe vendosja e shkollëve Emergjente në disa objekte shkollore	40

Furnizimi, vendosja dhe montimi i semaforëve dhe mirëmbajtja tri vjeçare e tyre.....	40
Gjetjet në aktivitetet e prokurimit në Podujevë	42
Ndërtimi i bulevardit dhe sheshit 'Sheshi i Dëshmorëve në qendrën e qytetit	42
Ndërtimi i objektit të ri të Emergjencës	44
Gjetjet në aktivitetet e prokurimit në Shtime	45
Furnizim me Mirëmbajte të Ndërtesave për Institucionet e Komunës së Shtimes	45
Furnizim me pajisje tjera për institucionet e Komunës së Shtimes/Ri-Tenderim	45
Gjetjet në aktivitetet e prokurimit në Zveçan.....	46
Projektit kryesor për ndërtimin e rezervuarëve të ujit të pijshëm në Zveçan	46
Shërbimet e sigurisë fizike të objektit të ZKK.....	47
Kontraktimi i shërbimeve nga OJQ-të përmes prokurimit publik.....	48
Gjetjet kryesore në menaxhimin e zbatimit të kontratave	52
Shkeljet ligjore lidhur me planin e menaxhimit të kontratave	52
Shkeljet ligjore lidhur me sigurimin e ekzekutimit të kontratave publike.....	52
Shkeljet ligjore lidhur me caktimin e afatit për zbatimin e kontratave	53
Pasojat e shkeljeve ligjore rreth lidhjes së kontratave për të cilat komunat nuk kanë pasur buxhet	54
Monitorimi i proceseve gjyqësore ndaj zyrtarëve të akuzuar për korrupsion në lidhje me prokurimin publik.....	55
Konkluzione	63
Rekomandime.....	67
Rreth INPO.....	69
Shtojcë: Aktivitetet e prokurimit të monitoruara	70

Lista e shkurtesave

AK	Autoritet Kontraktues
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
DNPDF	Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve
PMK	Plani për Menaxhimin e Kontratës
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LPP	Ligji për Prokurim Publik
RrOUP	Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik
OE	Operatorë Ekonomik
OJQ	Organizatë jo-qeveritare
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
ISO	Organizata Ndërkombëtare për Standardizim
KVK	Kushtet e Veçanta të Kontratës

Përmbledhje ekzekutive

Integriteti i proceseve të prokurimit publik në Komunat e Republikës së Kosovës vazhdon të jetë i cenueshëm. Përkundër faktit se legjislacioni në fuqi në fushën e prokurimit publik përmbushë standardet e pranueshme për të zhvilluar aktivitetet e prokurimit publik duke u bazuar në parimet e qeverisjes së mirë, në praktikë vazhdimisht cenohen këto parime, përfshi transparencën, llogaridhënien, mos-diskriminimin, integritetin etj.

Komunat e Republikës së Kosovës vazhdojnë të kenë probleme serioze në planifikimin e vlerave të kontratave publike. Ato vazhdimisht zhvillojnë aktivitete, të cilat rezultojnë me lidhjen e kontratave publike, që tejkalojnë vlerat e shumave të planifikuara me buxhetin komunal. Ky fenomen, ka ndikuar që Komunat të ndërtojnë praktika të këqija të qeverisjes, të cilat përveçse prodhojnë borxhe të komunës, rezultojnë me mungesë të realizimit të punëve me kohë dhe zbatimin e obligimeve të kontratave të lidhura me operatorë të ndryshëm ekonomik.

Zyrtarët e prokurimit publik nëpër komuna, në shumë raste të monitoruara, veprojnë në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik sa i përket afateve për tenderim, të cilat i shkurtojnë pa ofruar arsye të qëndrueshme, siç kërkohet me ligj. Gjithashtu, vazhdojnë të aplikojnë kritere kufizuese/diskriminuese, të cilat krijojnë pabarazi në mes të operatorëve ekonomik të interesuar për tenderim. Këto veprime të zyrtarëve të prokurimit publik mund të prodhojnë pasoja të pariparueshme për operatorët ekonomik, duke i dëmtuar në pjesëmarrje të tenderëve publikë, duke krijuar në këtë formë terren favorizues për operatorë të caktuar ekonomik, rrjedhimisht duke ofruar mundësi reale për zhvillimin e veprimtarive korruptive.

Njoftimet e publikuara rreth aktiviteteve të prokurimit publik në shumicën e rasteve publikohen me gabime përmbajtësore dhe teknike, të cilat cenojnë integritetin e procesit të prokurimit publik. Në këtë drejtim, janë shpeshtuar rastet kur zyrtarët e prokurimit, obligohen të përmirësojnë gabimet në njoftimet e publikuara. Shqetësues është fakti se këto përmirësime të gabimeve bëhen në kundërshtim me afatet ligjore dhe ndryshojnë në esencë kriteret e tenderëve të caktuar. Në raste të caktuara, përmirësimet janë bërë në ditën kur përfundon afati për tenderim. Kjo është e papranueshme dhe prapa këtyre veprimeve të kundërligjshme ngritën dyshime të arsyeshme se ato bëhen me qëllime të caktuara për të eliminuar apo favorizuar operatorë të caktuar ekonomik.

Fenomeni i shkeljes së Ligjit të Prokurimit Publik rezulton të jetë kontrata pa afatet e sakta se kur duhet të fillojnë dhe mbarojnë obligimet kontraktuale, respektivisht data e përfundimit të kontratës. Komunat kanë ndërtuar një praktikë të kundërligjshme të

lidhjes së kontratave publike me, duke përcaktuar kohëzgjatjen e kontratës me ditë pune/kalendarike ose muaj dhe jo me data të fillimit dhe mbarimit të kontratës.

Fenomen tjetër i kundërligjshëm i lidhjes së kontratave publike me operatorët ekonomik është periudha e validitetit të sigurisë së ekzekutimit të kontratës. Në shumicën e tenderëve të monitoruar, rezulton se validiteti i këtyre sigurimeve është në kundërshtim me ligjin, pasi që afatet e këtyre sigurimeve del se janë më të shkurta sesa kërkojnë me ligj apo del se ato skadojnë para përfundimit të kontratave. INPO gjen se ky fenomen ndodhë edhe si pasojë e mos përcaktimit adekuat të kohëzgjatjes së kontratës.

Komunat në aktivitete të caktuara të prokurimit publik kushtëzojnë operatorët ekonomik me punësimin e ish-punëtorëve të komunave. Gjetjet e monitorimit tregojnë se këto kushtëzime janë bërë ndaj operatorëve ekonomik në Gjilan dhe Ferizaj, lidhur me kontratat e pastrimit. Këto kushtëzime janë në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik, i cili në asnjë formë nuk lejon kushtëzime të kësaj natyre.

Ligji për Prokurimin Publik në fuqi i njëj OJQ-të si operatorë ekonomik, mirëpo nenin 132/A të këtij ligji, përcaktohet se Qeveria me akt nënligjor përcakton rregullat, standardet dhe procedurat e kontraktimit të shërbimeve publike për organizatat e shoqërisë civile. INPO ka gjetur se në Kosovë nuk ka legjislacion adekuat, i cili rregullon standardet dhe procedurat për kontraktimin e OJQ-ve për ofrimin e shërbimeve publike nga ana e komunave, ministrive, apo agjencive të pavarura. Qeveria deri më tash nuk ka nxjerrë ndonjë akt nënligjor, i cili rregullon këtë fushë. INPO ka gjetur se disa komuna tanimë kanë lidhur kontrata për shërbime me OJQ në vlera të majme monetare, përmes instrumentit të prokurimit publik. Në kuadër të monitorimit, janë hulumtuar katër (4) aktivitete të prokurimit, të cilat kanë rezultuar me lidhjen e kontratave publike për shërbime me OJQ, të cilat ofrojnë shërbime shëndetësore. Në asnjërën nga këto aktivitete të prokurimit nuk është shënuar se kontraktimi i shërbimeve është planifikuar të bëhet nga OJQ-të.

INPO vlerëson se komunat respektive gjatë udhëheqjes së procedurave për të kontraktuar shërbime mjekësore dhe ambulatore nga OJQ-të kanë vepruar në kundërshtim me bazën ligjore. Në bazë të hulumtimit, INPO ngritë dyshime se këto kontrata janë shfrytëzuar për të punësuar staf shëndetësorë në Qendrat e Mjekësisë Familjare të Komunave.

Komunat në raste të caktuara të monitoruara nga INPO kanë anashkaluar Organin Shqyrtues të Prokurimit apo Gjykatën e Tenderëve siç njihet në publik. Edhe pse kanë pasur procedura të hapura në këtë gjykatë, komunat kanë vendosur të nënshkruajnë kontratat me operatorët e caktuar ekonomik, pa pritur verdiktin përfundimtar. Kjo mënyrë e veprimit prodhon pasoja për Komunën.

Gjatë këtij viti, janë monitoruar 23 seanca gjyqësore, ku përfshihen nëntë (9) lëndë në të cilat akuzohen për korrupsion zyrtarët e prokurimit publik të nivelit të institucioneve

lokale dhe qendrore. Karakteristikë e këtyre rasteve është se gjatë këtij viti, gjykatësit kanë shpallur aktgjykime liruese në pesë (5) raste, ndërsa në katër (4) rastet e tjera po vazhdojnë shqyrtimet gjyqësore. Pra, ende nuk ka asnjë zyrtarë të prokurimit publik të akuzuar për korrupsion dhe të dënuar me burgim efektiv gjatë këtij viti.

Gjetjet tregojnë se në nivelin komunal në lidhje me kryerjen e veprave penale në fushën e prokurimit publik gjatë këtij viti janë duke u përballur me procedura gjyqësore Drejtori i Zyrës së Prokurimit në Gjilan, Lipjan dhe Prizren si dhe Kryetari i Komunës së Istogut, Haki Rugova. Ky i fundit, akuzohet se ia ka dhënë tenderin vëllait të tij, duke ia mundësuar dhënien e kontratës përmes procedurave të prokurimit publik, kontratë kjo, të cilën e kishte nënshkruar personalisht.

Rekomandohet që hetuesit policorë të krimeve ekonomike, prokurorët dhe gjykatësit duhet të profilizohen në fushën e prokurimit publik, për të mundësuar hetime, ndjekje dhe gjykime profesionale për të zbardhur aktivitetet kriminale të cilat zhvillohen përmes prokurimit publik. Politika e ndjekjes duhet të avancohet për të zhvilluar hetime të drejta dhe të bazuara në ligj, sikurse gjykatësit duhet të gjykojnë drejtë këto raste dhe në rastet kur gjejnë fajtor të akuzuarit në fushën e prokurimit publik të shqiptojnë dënime adekuate përmes të cilave arrihet qëllimi i dënimit.

Kryetarët e Komunave duhet të rrisin transparencën, mbikëqyrjen dhe llogaridhënien e zyrtarëve të prokurimit publik, të cilët haptas veprojnë në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik sa i përket afateve për tenderim, aplikimin e kriterëve kufizues/diskriminues dhe të tjera veprime që e cenojnë në çfarëdo forme integritetin e proceseve të prokurimit publik.

INPO rekomandon që në procesin aktual të analizimit të kornizës ligjore në fushën e prokurimit publik, të adresohet në mënyrë më specifike çështja e rregullimit të obligimeve që ndërlidhen me menaxhimin e kontratave publike, fushë kjo, në të cilën ka probleme të cilat karakterizohen si dukuri. Gjithashtu, Qeverisë së Kosovës i rekomandohet që të miratojë aktet nënligjore për të garantuar të drejtat e OJQ-ve që si operatorë ekonomik, të ofrojnë shërbime të ndryshme të cilat garantohen me Ligjin për Prokurimin Publik. Qeveria duhet të përcaktojë qartë rregullat, standardet dhe procedurat e kontraktimit të shërbimeve publike për organizatat e shoqërisë civile.

Metodologjia

Iniciativa për Progres (INPO) dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) *(në vazhdim të raportit e gjeni si INPO)* me qëllim që të hartojnë një raport sa më real dhe analitik në lidhje me zbatimin konceptual dhe sipas obligimeve ligjore të cikleve të prokurimit, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit dhe analizës.

Hulumtimi përfshinë monitorimin dhe analizimin e 160 aktiviteteve të prokurimit, respektivisht 80 aktivitete nga iniciimi i prokurimit e deri tek lidhja e kontratës dhe 80 aktivitete të menaxhimit të kontratës, në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Mesatarisht, secilës komunë i janë monitoruar katër (4) tenderë, dy (2) iniciime dhe dy (2) menaxhime të kontratës. Ky monitorim është zhvilluar në periudhën dhjetor 2018 deri në fillim të nëntorit 2019. Monitorimi gjithashtu përfshinë edhe rastet gjyqësore të zyrtarëve të prokurimit apo zyrtarëve të tjerë të akuzuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare në lidhje me prokurimin publik.

Hulumtimi dhe analizi i të gjitha dokumenteve dhe gjendjes faktike është bërë nga monitoruesit e IKD-së në të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës, nën udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e ekspertëve të prokurimit publik në INPO.

Metoda e përzgjedhjes së tenderëve/kontratave për tu analizuar dhe monitoruar është bazuar në indikatorë automatik siç janë: (i) aktiviteti i prokurimit me vetëm një ofertë, (ii) çmimi i kontratës është shumë afër çmimit të parashikimit të vlerës, (iii) rastet e eliminimit të të gjitha ofertave që kanë aplikuar, përveç asaj fituese, (iv) tenderët me afate të shkurtuara, (v) çmimi i ofertës fituese është më i lartë sesa parashikimi i vlerës së kontratës, si dhe sipas rrezikut të sektorit *(shtrimi të rrugëve, tenderët e sigurimit fizik, tenderët e pastrimit, furnizimeve, etj)*. Në disa raste është përdorur edhe metoda e rastësisë në përzgjedhje të tenderit apo kontratës.

INPO bazuar në obligimet ligjore dhe planet e prokurimit është bazuar në dy indikatorë kyç për vlerësimin e zbatimit të ligjit në procedurat dhe fazat e prokurimit gjatë zhvillimit të një aktiviteti të prokurimit dhe menaxhimit të kontratës.

Indikatori 1: Aktiviteti i prokurimit përfshinë të gjitha të dhënat e kërkuara sipas Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik (RrUOP). Ky indikator është matur duke analizuar dokumentet e secilit aktivitet, si në vijim:

1. Planifikimi përfundimtar i prokurimit;
2. Kërkesa për iniciimin e aktivitetit të prokurimit nga njësia kërkuuese;
3. Deklarata e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve (B04);
4. Njoftimi për kontratë (B05);
5. Dosja e tenderit (B17);

6. Paramasa dhe parallogaria;
7. Vendimi i formimit të Komisionit për hapje;
8. Procesverbali i hapjes së tenderit (B12);
9. Vendimi për krijimin e komisionit për vlerësimin e tenderëve;
10. Raporti i Vlerësimit të tenderëve (B36);
11. Njoftimi për dhënie të kontratës (B08);
12. Kontrata; si dhe
13. Vendimi për caktimin e menaxherit/es së projektit/kontratës.

Indikatori 2: Menaxhimi i kontratës përfshinë të gjitha të dhënat e kërkuara sipas LPP dhe RrUOP dhe legjislacionin sekondar, përfshi atë se:

1. A përmban dosja e menaxhimit të kontratës dokumentet e kërkuara për procesin e menaxhimit të kontratës – regjistri i menaxhimit të kontratës. (sipas RrUOPP neni 61.30)?;
2. A është caktuar Menaxheri i kontratës para fillimit të implementimit?;
3. A është përgatitur Plani i menaxhimit të kontratës dhe nëse po a është bërë më kohë dhe konform kërkesave të tij?;
4. A janë bërë pagesat sipas periudhave për pagesa të përcaktuara në kontratë?;
5. A ka pasur vonesa dhe a ka përfunduar kontrata?;
6. A janë zbatuar “ndëshkimet” për vonesat?;
7. A është kërkuar sigurimi i ekzekutimit të kontratës konform kërkesave ligjore?;
8. A është përcaktuar data e përfundimit të kontratës?;
9. A ka pasur Aneks Kontratë?;
10. Përshkrimi artikujve/punëve/shërbimeve nëpër pozicione a ka qenë favorizues për produkte të caktuara?; si dhe
11. A ka mekanizma të tjerë përveç menaxherit të projektit të cilët mbikëqyrin cilësinë e zbatimit të kontratës?

Të gjitha këto dokumente INPO i ka siguruar përmes kërkesave për qasje në dokumente publike dhe platformën elektronike për prokurim publik.

Pas sigurimit të dokumentacionit, INPO ka analizuar përmbajtjen e të gjitha dokumenteve të aktiviteteve të prokurimit, ka identifikuar gjetjet, ka bërë vlerësimet në lidhje dhe më pas ka zhvilluar vizita në terren, ka intervistuar zyrtarët e prokurimit si dhe aktorët e tjerë me rëndësi për hulumtimin.

Korniza ligjore vs praktika

Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës është i rregulluar me Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe legjislacionin përkatës sekondar, i cili përbëhet nga 84 akte nënligjore, duke përfshirë një dokument të përbashkët të quajtur Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik, të cilat japin udhëzime pothuajse në detaje si duhet të veprohet gjatë inicimit dhe zhvillimit në përgjithësi të aktiviteteve të prokurimit.

Ligji përmban parimet kryesore të qeverisjes së mirë si parimin e transparencës, llogaridhënës, mos-diskriminimit, integritetit etj. Ai reflekton gjithashtu parimet e prokurimit publik si: vlera në para, konkurrenca e lirë, transparenca, trajtimi i barabartë, njohja e dyanshme dhe parimi i proporcionalitetit.

Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.¹

Raportet e ndryshme ndërkombëtare dhe lokale, përfshirë edhe raportet e fundit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, konstatojnë se organizatat e ndryshme buxhetore (lokale dhe qendrore) në masë të madhe atakohen me vërejtje sistematike sa i përket realizimit të aktiviteteve të prokurimit, duke krijuar dyshime të bazuara për afëra korruptive. Komoditet të shtuar për mosadresimin e këtyre vërejtjeve dhe të gjeturave ofron mosfunksionimi i mekanizmave të llogaridhënies institucionale, politike dhe ligjore.

Komunat si autoritete kontraktuese, vazhdojnë në përballen me probleme të shumta në shpenzimin e parasë publike, përmes instrumentit të prokurimit publik. Keqmenaxhimi dhe moszbatimi konceptual i cikleve të prokurimit nga faza e planifikimit e deri tek certifikimi i punimeve mbeten sfida të pakapërcyeshme nga komunat, ani pse zyrtarët komunal vazhdimisht deklarohen se shpenzimi i parasë publike bëhet sipas ligjit dhe praktikave më të mira qeverisëse.

Nga 1 janari 2019, të gjitha procedurat e prokurimit (*vlera e vogël, e mesme dhe e madhe*), përveç vlerave minimale dhe/ose procedurave, të cilat nuk mund të zhvillohen

¹ Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 18. 19 shtator 2011. (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>).

përmes platformës, janë zhvilluar përmes platformës elektronike të prokurimit. Ky veprim ka mundësuar një transparencë më të madhe në favor të OE si dhe OJQ-ve që monitorojnë prokurimin publik.

Po ashtu, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, ka obliguar të gjitha AK-të që të bëjnë publikimin proaktiv të njoftimeve siç janë a) *Njoftim paraprak*; b) *Njoftim për kontratë*; c) *Njoftim mbi vendimin e AK*; d) *Njoftim për dhënie të kontratës*; e) *Njoftim për anulim të aktivitetit të prokurimit*; f) *Njoftim për informata shitesë ose përmirësim gabimi*; dhe g) *Njoftim për nënshkrim të kontratës*. Po ashtu, kontratat e lidhura së bashku më listën e çmimeve janë obligim ligjor që të publikohen nga të gjitha autoritetet kontraktuese.²

Nga 80 tenderë të monitoruar nga faza e inicimit të aktivitetit e deri tek nënshkrimi i kontratës, rezulton se 25 tenderë nuk i kanë publikuar të gjitha njoftimet sipas obligimeve ligjore. Nga këta 25 tenderë, në 12 tenderë nuk janë publikuar njoftimet mbi vendimin e autoritetit kontraktues, në 15 tenderë nuk janë publikuar Kontrata me listën e çmimeve të kontraktuara, në 9 tenderë nuk janë publikuar letrat standarde, në 3 tenderë nuk janë publikuar njoftimi për dhënie dhe në një tender nuk është publikuar njoftimi për përmirësimin e gabimeve apo informatave shitesë edhe pse AK i ka ndryshuar ato.

Mos publikimi i këtyre njoftimeve jo domosdo kompromenton aktivitetin e prokurimit në aspektin e shkeljeve të rënda, megjithatë këto veprime përbëjnë shkelje ligjore dhe bien në kundërshtim me parimet kryesore të transparencës në prokurim publik, të cilat në thelb e cenojnë integritetin e një aktiviteti të prokurimit publik.

Sa i përket zbatimit të ligjit dhe praktikave lidhur me vendosjen e kriterëve dhe kushteve të tenderit, afateve ligjore, hartimit të specifikacioneve teknike, dhe në përgjithësi plotësimit të dosjes së tenderit, vlerësimit të tenderëve dhe veprimeve tjera ligjore deri tek dhënia e kontratës, të gjeturat nga monitorimi tregojnë se në të gjitha këto faza ka shkelje të ligjit. Po ashtu, zbatimi i obligimeve ligjore për menaxhimin efikas të kontratave mbetet sfidë e pakapërcyeshme për komunat.

Në 25 tenderë të monitoruar, INPO ka gjetur se dosjet e tenderit nuk janë plotësuar sipas udhëzimeve të LPP dhe RrUOP. Gjetjet tregojnë se shkeljet më të shpeshta që komunat i bëjnë janë: mos hartimi i kushteve të veçanta të kontratës³, vendosja e kriterë diskriminuesë që kufizojnë konkurrencën, mos respektimi i afateve ligjore gjatë fazës së tenderimit ose gjatë fazës së vlerësimit të tenderëve, si dhe mos përcaktimi adekuat i kohëzgjatjes së kontratës. Ndërkaq sa i përket zbatimit të kontratave, INPO ka gjetur komunat në përgjithësi, respektivisht menaxherët e kontratës nuk e kanë hartuar Planin

² Neni 22, i Rregullave dhe Udhëzuesit për Prokurim Publik, i zbatueshëm nga 10.04.2019.

³ **Shënim:** Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, në nenin 18, obligon zyrtarin e prokurimit që të plotësoj kushtet e veçanta të kontratës në kohën e përgatitjes së Dosjes së Tenderit

për Menaxhimin e Kontratës sipas kërkesave ligjore, i cili është dokument parësor, përmes të cilit vendosen kushtet dhe afatet për menaxhim dhe zbatim efektiv të kontratës së punës, shërbimeve apo furnizimeve.⁴

⁴ *Shënim:* Autoritetet kontraktuese duhet që si pjesë e përgatitjes së aktivitetit të prokurimit të prodhojnë një plan të menaxhimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet e aspekteve organizative, ekonomike, teknike dhe ligjore të menaxhimit të kontratave duke përfshirë në bazë të rrethanave: (i) ekipet e menaxhimit të projekteve; (ii) rishikime të shpeshta të kontratës; (iii) protokollet për dorëzimin e pajisjeve të autorizuara; (iv) dialogun e rregullt me kontraktuesit; (v) përdorimin e standardeve korrekte të cilësisë; (vi) menaxhimit të pagesave / kërkesave; (vii) procedurat e ankesave; (viii) mjetet e kontrollit të specifikuar në kontratë, dhe (ix) sigurimi i ekzekutimit mbahet për defekte / korrigjim dhe përcakton procedurat për këto në vijim sa herë që është e nevojshme: (i) inspektimin e vendit të punimeve, materialeve dhe të objekteve të prodhimit; (ii) sigurimin e dorëzimit efektiv, ruajtjen dhe sigurinë e artikujve të përfshira në kontratë; (iii) caktimi i afatit të dorëzimit; (iv) variacionet / ndryshimet (neni 81, LPP)

Gjetjet kryesore në monitorimin e aktiviteteve të prokurimit publik

INPO ka monitoruar 80 aktivitete të prokurimit në fazën e tenderimit, në të gjitha komunat prej publikimit të njoftimit për kontratë deri tek nënshkrimi i kontratës. INPO është fokusuar në monitorimin e zbatimit të LPP-së dhe aplikimit të rregullave të prokurimit, respektivisht, dhe devijimet apo shkeljet e ligjit në fazën tenderuese.

Gjetjet nga monitorimi tregojnë se komunat kanë bërë përparim të mirë, por ato ende kanë probleme në respektimin e LPP-së dhe nuk e zbatojnë në plotëni RrOUP-in. Analiza dhe gjetjet janë të paraqitura në mënyrë individuale për secilën tender në vazhdim të këtij raporti.

Si rezultat i punës së INPO-s gjatë monitorimit, duke luajtur rolin e mbikëqyrjes, rastet e shkeljeve dhe gabimeve që kanë mundur të parandalohen, janë adresuar si gjetje, vlerësime dhe rekomandime, pas të cilave komunat kanë treguar bashkëpunim dhe i kanë adresuar ato duke bërë përmirësimin e gabimeve në njoftimet e publikuara apo duke i anuluar në tërësi.⁵ Vlera e përafërt e tenderëve të përmirësuar apo të anuluar është rreth 1,500,000€. Ky është vetëm një model se si organizatat e shoqërisë civile përmes monitorimit mund të ndikojnë në përmirësimin e prokurimit në përgjithësi.

INPO ka identifikuar një numër të gjetjeve të cilat janë të përbashkëta për të gjitha komunat, por gjithashtu janë evidentuar edhe shkelje të cilat janë karakteristike të vetëm një komune.

Disa prej gjetjeve kryesore të këtij raporti përfshijnë:

- Planifikimi jo adekuat i kostos financiare të tenderëve. Vlerat e parashikuara të kontratave nuk janë në harmoni me planifikimin përfundimtar të prokurimit, njoftimit për kontratë dhe buxhetit të komunës.
- Shkurtimin e afateve për tenderim në kundërshtim me ligjin apo pa ofruar arsye të qëndrueshme. Shembull komuna e Deçanit ka bërë shkurtimin e afateve për tenderin me vlerë të madhe, në 20 ditë.
- Aplikimin e kriterëve kufizues/diskriminues të cilat krijojnë pabarazi mes OE të interesuar për tenderim, siç janë kufizimi i numrit projekteve si dëshmi për kapacitet teknik dhe profesional, kufizimi i numrit të punëtorëve që duhet dëshmuar me lista nga ATK-ja, kërkesat për ISO standarde jo relevante apo që janë shfuqizuar, dëshmi se nuk kanë obligime të pashlyera ndaj komunës apo

⁵ Shih linkun: <http://inpo-ks.org/komunat-adresojne-rekomandimet-e-inpo-s-duke-permiresuar-gabimet-ne-aktivitete-te-prokurimit/>

edhe rastet kur OE-të që kanë kontrata të papërfunduara me komunën kufizohen të aplikojnë.

- Korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara në kundërshtim me ligjin, si në kontratat e Ferizajt, ku 2 ditë para datës përfundimtare për ofertim ndryshohen në mënyrë esenciale kushtet e tenderit dhe nuk zgjatet afati për tenderim, apo në Mitrovicën e Jugut, ku korrigjimet janë publikuar në ditën kur përfundon afati për tenderim.
- Mos hartimi i kushteve të veçanta të kontratës në kohën e përgatitjes së dosjes së tenderit, kushtet që duhet ti pranojë tenderuesi që konkurron në atë mënyrë që kështu që të mos lejohen negociatat Shumica e komunave në tenderët e monitoruar nuk i kanë plotësuar kushtet e veçanta në fazë tenderuese.
- Mos hartimi i specifikimeve teknike të detyrueshme në dosje të tenderit. Shembull, në dy tenderët e monitoruar të komunës së Shtimes nuk ka pasur specifikime teknike. Apo tenderi për pastrim të objekteve i Ferizajt, që specifikimet teknike nuk i ka autentike. Ligji parasheh që ato të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë dyshime rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara.
- Vonesat në vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve. Komunës së Gllogocit dhe të Ferizajt i ishin dashur mbi 40 ditë për vlerësimin e ofertave edhe pse natyra e tenderëve nuk ishte komplekse.
- Në përgjithësi, komunat nuk saktësojnë datën e fillimit dhe të mbarimit të kontratës. Kohëzgjatja e kontratës shprehet me ditë pune/kalendarike ose muaj.
- Definimi i validitetit të sigurisë së ekzekutimit të kontratës është problem në vetë, ku shumica e tenderëve validitetin e kanë në kundërshtim me ligjin. Kjo si pasojë edhe e mos përcaktimit adekuat të kohëzgjatjes së kontratës.
- Pranimi i çmimeve për shërbime me 0.01€ apo edhe me 0.001€ e cila është evidentuar në kontratën e pastrimit të objekteve të komunës së Gjilanit.
- Kushtëzimi i OE që të punësojnë ish punëtorët e komunës në kontratat e pastrimit, si rasti i komunës së Gjilanit dhe Ferizajt.
- Nënshkrimi i kontratës pa pasur ndonjë vendim nga OSHP-ja, rreth ankesës së OE- së ankues, rasti i komunës së Junikut, ku ende pa marrë vendim OSHP-ja komuna ka nënshkruar kontratën.

Gjetjet në aktivitetet e prokurimit në Drenas

Stërzgjatja e procedurave të vlerësimit në kundërshtim me ligjin dhe mos saktësimi i kohëzgjatjes së sigurisë së ekzekutimit të kontratës, janë dy prej gjetjeve kryesore në tenderët e monitoruar të komunës së Drenasit.

Intervenimet emergjente

Nënshkrimi i kësaj kontratë është bërë më 10.05.2019 me OE “KASTRATI-L”, me çmim prej 29,096€. Sipas dispozitave të kësaj kontrate, kohëzgjatja e saj është 12 muaj.

Për këtë kontratë siguria e ekzekutimit nuk është bërë sipas kërkesave ligjore. Validiteti i sigurimit të kontratës është kërkuar deri në datën e përfundimit të kontratës. Ndërkaq, sigurimi duhet të mbetet valid për një periudhë prej 30 ditësh pas kompletimit të kontratës.⁶ Kjo masë siguron komunën që në rast të shkeljes së kontratës së nënshkruar, e cila shkakton dëme materiale për AK dhe/ose kërkon që AK të shkaktojë shpenzime të konsiderueshme në përfundimin e kontratës, e njëjta të bëjë konfiskimin e sigurisë, duke mbrojtur investimin dhe interesin e komunës.

Furnizim me artikuj higjienik: Institucionet Komunale–Administrata, Arsimi dhe Shëndetësia

AK procesin e vlerësimit të ofertave për këtë tender nuk e ka bërë brenda periudhës ligjore prej 30 ditëve nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse (*në rastin konkret, kjo kontratë nuk është komplekse*), kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Hapja e ofertave është bërë më 06.03.2019, ndërsa raporti i vlerësimit të ofertave ka është hartuar më 24.04.2019.⁷ Rrjedhimisht, Komunës së Malishevës i janë nevojitur 47 ditë që ta bëjë vlerësimin e ofertave, pra 17 ditë më shumë se sa është e lejuar me këtë dispozitë.

Fitues i kontratës ishte OE “GIPA”, me çmim prej 11,468.54€. Sipas dispozitave të kësaj kontrate kohëzgjatja e saj është gjashtë (6) muaj.

⁶ Neni 63, i LPP-së dhe nenit 30.6 të RrUOPP.

⁷ Raporti i vlerësimit, i siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike

Gjetjet në aktivitetet e prokurimit në Deçan

Gjatë monitorimit të dy (2) aktiviteteve të prokurimit publik në Komunën e Deçanit, INPO ka gjetur se komuna në njërin tender ka vendosur kritere diskriminuese dhe vlera e parashikuar e kontratës nuk ishte identike në dokumentet e planifikimit të prokurimit, njoftimit për kontratë dhe buxhetit. INPO ka rekomanduar Komunës që të adresoj gjetjet në fazë tenderuese, mirëpo komuna nuk i ka adresuar. Po ashtu, shkelje janë gjetur edhe në mos hartimin e kushteve të veçanta të kontratës dhe validitetit të sigurisë së kontratës.

Ndërtimi – Zgjerimi i rrugës R107 qendrore në Deçan (Ura e Demës–Carrabreg)

Njoftimi për kontratë për këtë tenderë ishte bërë më 03.04.2019. Tenderi është zhvilluar sipas procedurës së hapur me vlerë të parashikuar të kontratës 5,900,000€. Sipas planifikimit përfundimtarë të prokurimit për vitin 2019, vlera e parashikuar e këtij tenderi ishte 850,000€.⁸ Njëjtë ishte planifikuar edhe me Ligjin për Buxhetin e vitit 2019.⁹

Për këtë tender është bërë shkurtimi i afateve ligjore për pranimin e tenderëve nga 40 ditë sa përcaktohet për aktivitete me vlera të mëdha, në 20 ditë. Ndërsa në njoftimin për kontratë nuk është evidentuar se është bërë shkurtimi i afatit, apo ndonjë arsyetim për këtë shkurtim të afatit.¹⁰ INPO ka gjetur se komuna më 25.02.2019 kishte publikuar njoftimin paraprak për këtë tender. Sipas RrUOPP, neni 6, paragrafi 6.4, pika b. Njoftimi paraprak: “Mundëson reduktimin afateve minimale kohore për kontratat me vlerë të madhe, por jo më pak se 24 ditë *(në vend të afatit minimal kohor të zakonshëm prej 40 ditë)*. Po ashtu, në Njoftimin Paraprak¹¹ vlera e parashikuar e kontratës është 850,000€, e cila ka ndryshim të madh nga vlera e parashikuar në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, ku vlera e parashikuar është 5,900,000€.

Sa i përket kapacitetit teknik dhe profesional, është kërkuar nga OE që të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në tri (3) vitet e shkuara nga publikimi i njoftimit për kontratë në një vlerë prej jo më pak se 8,000,000€, ku minimumi dy projekte duhet të jenë “Zgjerim i rrugëve rajonale.” INPO vlerëson se kjo kërkesë, nuk është në pajtim me dispozitat e LPP, respektivisht me nenin 69, paragrafi 6.2 të LPP-së. AK nuk duhet të kufizoj konkurrencën, duke kërkuar kontrata me emër specifik të projektit e aq më tepër të kufizoj numrin e tyre. Po ashtu, në kundërshtim me nenin 69 është edhe kërkesat tjetër, që udhëheqësi i punishtes dhe inxhinieri i gjeodezisë

⁸ Plani i prokurimit 2019, Komuna Deçan, i qasshëm në <https://kk.rks-gov.net/decan/category/prokurimi/?page=7>

⁹ Ligji për Buxhetin 2019, i qasshëm në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4CEFBA4C-4397-4901-AB93-2AA37F43A9F7.pdf>

¹⁰ Dosja e tenderit, e qasshme në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=327>

¹¹ Njoftim paraprak, i qasshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=343085

të kenë përvojë në realizimin e së paku dy projekteve në lëminë e kërkuar. (*Zgjerim i rrugëve rajonale*). INPO, konsideron se këto kërkesa nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së dhe mund të jenë diskriminuese dhe për më tepër eliminojnë konkurrencën në mes të OE, për shkak se mjafton vetëm përvoja e tyre e sidomos përvoja në ndërtim të rrugëve apo rikonstruktiv të tyre.

INPO ka reaguar më kohë në lidhje me këto shkelje ligjore, duke e njoftuar AK për këto gjetje në dosjen e tenderit, mirëpo AK ka refuzuar që t'i përmirësojë ato.

Në këtë tender kishin ofertuar gjashtë (6) OE. Katër (4) nga gjashtë (6) OE kishin ofertuar me çmim më të lartë se vlera e parashikuar e kontratës. Vetëm dy (2) OE kishin ofertuar me çmim më të lirë.

Katër (4) OE ishin eliminuar si rezultat i mospërbushjes së kërkesave të dosjes së tenderit, një OE është shpallur i pasuksesshëm për shkak se nuk ishte çmimi më i lirë¹². Ndërkaq, fitues i kontratës ishte "Lika Trade", me çmim 5,884,040.40€ apo vetëm për 15,960€ më lirë se vlera e parashikuar.

Asfaltimi i rrugëve në fshatin Irzniq

Gjatë kohës së përgatitjes së kontratës, AK ka bërë shkelje të dispozitave të prokurimit publik, përkatësisht shkelje të nenit 18.3, Pjesa B, të RRUOPP, duke mos plotësuar Kushtet e Veçanta të Kontratës.¹³

Kohëzgjatja e kontratës sipas njoftimit për kontratë ishte 24 muaj.¹⁴ Po ashtu, validiteti i sigurisë së ekzekutimit të kontratës ishte kërkuar në afat prej 25 muaj, *ndërkaq kohëzgjatja e kontratës sipas Kushteve të Veçanta të Kontratës është 13 muaj*.¹⁵

Nënshkrimi i kontratës është bërë më 26.06.2019 me OE "Arfa Group", me çmim prej 187,513.60€.

¹²Njoftim mbi vendimin e AK, i qasshëm në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=327>

¹³ Dosja e Tenderit, e qasshme në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=327>

¹⁴ Njoftimi për kontratë, i qasshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=447471

¹⁵ Kontrata, e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=447471

Gjetjet në aktivitetet e prokurimit në Gjiilan

Pastrimi i objekteve komunale

Në këtë rast të monitoruar, INPO gjen se publikimi i njoftimit për kontratë ishte bërë më 24.09.2018, ndërsa vlera e parashikuar e kontratës ishte 540,000€ dhe aktiviteti ishte zhvilluar sipas procedurave të hapura.

Për këtë tender kishin ofertuar pesë (5) OE. Tre (3) prej tyre, kishin ofruar oferta më të lira se OE fitues.

Gjatë fazës tenderuese OE të interesuar kishin parashtruar pyetje në AK për sqarim të dosjes së tenderit. Njëra ndër pyetjet e parashtruara nga OE-të ishte për pozicionin Nr.22 në listën e çmimeve, ku në përshkrim të pozicionit kërkohej “Pastrimi i automjeteve te parku i makinave me një (1) punëtorë (gjatë orarit të punës) çmimi të jepet për një punëtor për një muaj”, ndërkaq tek sasia për të njëjtin pozicion kërkohej dy (2) punëtorë. AK kishte sqaruar se këtë shërbim duhet ta kryej vetëm një (1) punëtorë dhe të procedohet me vetëm një (1) punëtorë. Këtë sqarim AK e kishte publikuar edhe në platformën e prokurimit.¹⁶ Mirëpo, AK kishte dështuar që këtë sqarim/përmirësim ta bëj pjesë përbërëse të dosjes së tenderit ashtu siç obligohet me ligj.

Pas vlerësimit të ofertave, AK kishte shpallur fitues OE “Arianiti-A” më vlerë totale të ofertës prej 536,776.64€. Dy (2) OE ishin eliminuar nga tenderi me arsyetimin se kishin ndërhyrë në pozicionin 22 të shënuar më lartë, duke ofertuar vetëm me një (1), ndërsa kërkesa e AK ka qenë dy (2). Gjetjet dëshmojnë se OE kishin ofertuar sipas sqarimeve që kishte dhënë vetë AK.

OE, i cili nuk ishte pajtuar me vendimin e komunës ndaj kërkesës për rishqyrtim dhe i cili po ashtu kishte ofertën më të lirë se OE fitues, ishte ankuar në OSHP.

OSHP-ja kishte gjetur se komuna ka vepruar në kundërshtim me ligjin pasi nuk i është përmbajtur sqarimeve, të cilat i ka dhënë gjatë fazës tenderuese dhe në këtë mënyrë, OSHP-ja ka vendosur që lënda të kthehet në rivlerësim.¹⁷ Po ashtu, OSHP-ja kishte konstatuar se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk e kishte ofruar deklaratën tatimore për tri (3) vitet e fundit nga ATK-ja, sikurse ishte kërkuar në dosje të tenderit. OSHP-ja kishte konstatuar se komuna gjatë rivlerësimit të tenderëve duhet të rekomandoj për dhënie të kontratës OE që i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit si dhe sqarimet e dhëna të komunës për këtë aktivitet me qëllim që vlerësimi i ofertave të bëhet sipas ligjit.

¹⁶ Shih linkun: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=327>

¹⁷ Vendimi PSH.nr.663/18, i qasshëm në: <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2019/663-18vend.pdf>

INPO ka gjetur se komuna ka bërë rivlerësimin e ofertave, mirëpo nuk i është përmbajtur konstatimeve dhe rekomandimeve të OSHP-së dhe përsëri ka shpërblyer me kontratë OE “Araniti-A”¹⁸, i cili kishte ofertuar në kundërshtim me sqarimet e AK-së për pozicionin 22 dhe po ashtu nuk i kishte pasur deklaratat tatimore për tri (3) vitet e fundit.

INPO ka gjetur se në këtë rast, nuk ka pasur ankesa tjera pas rezultateve të rivlerësimit. INPO ka kontaktuar me përfaqësuesin e OE ankues për të parë arsyet se pse nuk ishte ankuar tutje ndaj rezultateve të rivlerësimit. Përfaqësuesi i OE ankues ka deklaruar se “ka qenë duke u trajtuar jashtë vendit në kohën kur komuna ka publikuar rezultatet e tenderëve pas rivlerësimit dhe nuk ka pasur mundësi të merret me këtë çështje”. Mirëpo, në bazë të hulumtimit, INPO ka gjetur se OE ankues në konzorcium me një OE tjetër ka fituar kontratën për pastrimin e objekteve shkollore në vlerë prej 1,256,049.98€.¹⁹

INPO ka analizuar kontratën dhe listën e çmimeve me OE “Arianti-A”, dhe ka gjetur se çmimet e kontraktuara për pozicione të njëjta dallojnë esencialisht me njëra tjetrën. Madje, për pastrimin e një (1) metri katror të hapësirave të jashtme të objekteve është kontraktuar çmimi prej 0.01€ apo edhe 0.001€.

12	Selishta"	m ²	jashtë	8300	0.03	8964.00
	Objekti Palestes se sporteve "Bashkim Selishta" pastrimi PAS TUBIMEVE KULTURORE E POLITIKE, NDESHJEVE SPORTIVE etj, sipas kërkesës së udhëheqësit të palestrës.		brenda	4800	0.005	864.00
13	Pastrimi i fasades se varur strukturale (xhamat e jashtem) te objekti I	m ²	jashtë	8300	0.001	298.80
14	ADMINISTRATES DHE SHERBIMET PUBLIKE	m ²	jashte	385	0.01	138.60
			brenda	1110	0.01	399.60
15	Ish-Objekti I Bibliotekes	m ²	jashtë	300	0.01	108.00
	Pastrimi i fondit librar te bibliotekes se qytetit (dy herë në muaj) sipas rregullave për mirëmbajtje të librave të sasisë prej rreth 50 000 librash	punëror		2	335	24120.00

Foto 1: Përshkrimi i çmimeve.

Tutje edhe në këtë tender INPO ka gjetur se Komuna ka bërë kushtëzimin e OE fitues që të punësojë gjashtë (6) ish-punëtorë të pastrimit të komunës. **Nenit 7 i LPP-së**, ndalon AK-të të kërkojnë nga OE që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike.

¹⁸ Njoftim për dhënie të kontratës, i qasshme në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=327>

¹⁹ Njoftim për dhënie të kontratës, i qasshëm në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=327>

Gjetjet në aktivitetet e prokurimit në Ferizaj

Në tenderët e monitoruar të komunës së Ferizajt, janë gjetur shkelje të rënda të cilat kanë rezultuar në favorizimin e OE. Në dy (2) nga tri (3) tenderët e monitoruar janë gjetur shkeljet e njëjta, siç është ndryshimi i kriterëve për tenderim në kundërshtim me ligjin dhe kushtëzimi i OE fitues për të punësuar ish punëtorët e komunës.

Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve në kuadër të Komunës së Ferizajt

Më 17 shtator 2018 komuna e Ferizajt kishte publikuar tenderin me vlerë të parashikuar të kontratës 250,000€. Në planifikimin përfundimtar të prokurimit për vitin 2019, kjo kontratë ishte planifikuar të zhvillohej në muajin mars 2018, me vlerë të parashikuar 103,060€. Pavarësisht, mospërputhshmërisë së vlerës së parashikuar në planifikim dhe njoftimin për kontratë, AK nuk kishte zotuar mjete fare para inicimit të tenderit.²⁰ Fillimisht për këtë tender ishin vendosur kërkesa minimale të kushteve të pjesëmarrjes, nuk ka pasur asnjë kërkesë për kapacitetin ekonomik dhe financiar të operatorëve ekonomik. Më 22 tetor 2018 AK ka publikuar në sistemin e e-prokurimit, formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, duke ndryshuar në mënyrë esenciale kushtet për pjesëmarrje në tender. Ky përmirësim është bërë saktësisht 40 ditë pas publikimit të njoftimit për kontratë dhe vetëm dy (2) ditë para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve.²¹ AK nuk e ka zgjatur afatin për dorëzimin e tenderëve në mënyrë që të ju sigurohet kohë e mjaftueshme OE për të përgatitur ofertën e tyre sipas kërkesave të reja dhe as nuk e ka anuluar e aktivitetin e prokurimit.

Në bazë të analizës së dosjes së tenderit, INPO gjen se specifikimet teknike dhe të detyrueshme nuk janë hartuar nga AK, por ato janë kopjuar nga një dosje tjetër e tenderit për nevojat e pastrimit të një kampusi universitar, pasi në dosje të tenderit figurojnë një varg i punëve, në të cilat përshkrimi rezulton të jetë “pastrim i klasëve, pastrimi special i dyshemesë së palestrës, etj.”²²

Në anën tjetër, në përshkrimin e çmimeve të publikuara në e-prokurim për këtë kontratë, AK nuk ka nuk e shpjeguar qartë dhe kuptueshëm për OE se si duhet llogaritur njësia matëse për pastrim dhe mirëmbajtje, si dhe furnizimet me material higjienik. Shembull: AK nuk ka bërë një ndarje për (i) hapësirën e brendshme, (ii) hapësirën e jashtme, (ii) hapësirën e betonuar, (iii) hapësirën e dritareve, (iv) furnizimet etj., por ka shënuar në mënyrë të përgjithësuar vetëm metrat katrorë të sipërfaqeve të objekteve, si dhe nuk ka specifikuar llojin dhe sasinë e furnizimeve që nevojiten për pastrim.

²⁰ Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve e datës 12.09.2018, e siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike.

²¹ Shënim: Sipas Njoftimit për Kontratë, afati i fundit për dorëzimin e tenderëve ishte 24 tetor 2018.

²² Dosja e tenderit, e qasshme në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=327>

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Objekti i Komunës	m ²	3.120,00
2	Qendra e Kulturës	m ²	1.096,00
3	Qendra për Punë Sociale (QPS)	m ²	288,00
4	QMF-I	m ²	1.137,00
5	QMF-II	m ²	830,00
6	QMF-III(Greme)	m ²	180,00
7	QMF-IV	m ²	792,00
8	QMF-VI	m ²	340,00
9	AMF(Dardani)	m ²	100,00
10	AMF(Llojza)	m ²	80,00
11	SHEP	m ²	670,00
12	QKMF	m ²	1.400,00
13	DAT-Kabineti-RTG	m ²	335,61
14	Objekti i Gjykatës	m ²	1.294,00
15	Teatri “Adriana Abdullahu”	m ²	800,00
16	Biblioteka “Sadik Tafarshiku”	m ²	700,00
17	Arkiva	m ²	240,00
18	Pastrimi i dritareve te objektit te komunës nga ana e jashtme 2 herë në vjet		4

Tabela 1: Lista e çmimeve

INPO gjen se në kundërshtim me ligjin, AK ka vendosur kusht për OE fitues, të cilin nuk e ka shënuar në dosje të tenderit. Sipas shënimit tek Lista e çmimeve, OE fitues është i obliguar që t’i pranoj në punë ish-punëtorët e Komunës dhe institucioneve të tjera, të cilët kanë qenë punëtorë të përhershëm në këto institucione, numri i të cilëve është 26, ku paga mujore duhet të jetë 260€ neto.²³ Në këtë mënyrë AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP, i cili ndalon AK të kërkojë nga OE që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos

²³ Përshkrimi i çmimeve, i qasshëm në <https://e-prokurimi.rks.gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=327>

punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike.²⁴

Gjatë procesit të vlerësimit, të gjithë OE ofertues janë shpallur të pa përgjegjshëm dhe janë eliminuar. Vetëm grupi i OE “Skyfterat – Live” Sh.P.K dhe N.SH.H. “Zona Park”, sipas raportit të vlerësimit ka qenë i përgjegjshëm dhe është shpërblyer me kontratë. Vlen të theksohet se ofertat e katër (4) OE të eliminuar kanë qenë më të lira se oferta e OE fitues.

Tenderuesi	Çmimi me TVSH	Statusi pas Vlerësimit
N.P.L “Ambienti” Sh.A	273,807.00€	Eliminuar
N.SH “CLEAN”	170,353.64€	I papërgjegjshëm
“Skyfterat – Live” Sh.P.K dhe N.SH.H. “Zona Park”	249,680.00€	Fitues i kontratës
N.T.P “Beni”	238,158.64€	I papërgjegjshëm
“Selmans Network” Sh.P.K	239,030.40€	I papërgjegjshëm
“Mobile Sanitary Services MSS” Sh.P.K	238,210.32€	I papërgjegjshëm

Tabela 2: Lista e OE ofertues dhe statusi i tyre pas vlerësimit të tenderëve.

INPO ka gjetur se AK ka bërë shkelje të nenit 41.3 të RrUOPP, me ç’rast, vlerësimi i ofertave nuk është bërë në bazë të kriterëve të specifikuar në Dosjen e Tenderit, kjo për shkak se në Raportin e Vlerësimit, mungojnë kriteret sa i përket përshtatshmërisë dhe aftësive profesionale të tenderuesve. Respektivisht, kriteret e vendosura në dosje të tenderit nuk janë identike me kriteret e vendosura në raport të vlerësimit.

Formimi i komisionit të vlerësimit të ofertave është bërë më 14.11.2018, saktësisht 20 ditë pas hapjes së tenderëve dhe periudha e vlerësimit të ofertave kishte zgjatur 49 ditë.²⁵

AK ka shpërblyer me kontratë grupin e OE **“Skyfterat – Live” dhe “Zona Park” me vlerë të kontratës 249,680€**. OE “CLEAN” i shpallur i papërgjegjshëm ka parashtruar **Kërkesë për Rishqyrtim** në AK me pretendimin se AK gjatë vlerësimit të tenderëve ka bërë shkelje të nenit 6, 7, 59, 72 dhe 39 të LPP-së.

²⁴ Paragrafi 5, neni 7, i Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë, i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

²⁵ *Shënim:* Sipas ligjit procesi i vlerësimit të tenderëve duhet të filloj jo më vonë se pesë (5) ditë nga data e hapjes së tenderëve dhe nuk duhet të zgjasë më shumë se 30 ditë.

AK në bazë të vendimit nr.01-235 të datës 18.12.2018, i refuzon ankesën OE me arsyetimin se pikat ankimore të paraqitura në kërkesë për rishqyrtim janë të pabazuara për shkak se OE “CLEAN” sipas raportit të vlerësimit ka ofruar çmim jo-normalisht të ulët dhe për këtë është njoftuar OE përmes letrës standarde. Mirëpo, INPO ka gjetur se AK Komuna e Ferizajt nuk e ka njoftuar KRPP-në për eliminimin e OE për shkak të ofrimit të ofertës me çmim jo-normalisht të ulët, ashtu sikur obligohet me nenin 61 të LPP-së, i cili i obligon AK-të që brenda dy (2) ditëve nga data e ndonjë refuzimi të ofertave me çmim jo-normalisht të ulët ta njoftoj KRPP-në.

Në anën tjetër, sipas raportit të vlerësimit të ofertave, OE “CLEAN” figuron se është eliminuar nga tenderi për arsye se nuk i ka plotësuar kushtet teknike dhe profesionale, ndërsa nuk figuron askund se OE “CLEAN” ka ofruar tender më çmim jo-normalisht të ulët.²⁶

Sigurimi fizik i objekteve në kuadër të Komunës së Ferizajt

Ky tender ishte planifikuar të fillojë në muajin shkurt 2018, me vlerë ta parashikuar të kontratës **156,932 euro**.²⁷ Mirëpo, publikimi i **Njoftimit për Kontratë** është bërë më 17.09.2018, respektivisht pas 8 muajve. Sipas njoftimit vlere e parashikuar e kontratës ishte 200 mijë euro. Ndërkaq, në **dosjen e tenderit, vlere e parashikuar** ishte **300 mijë euro**.²⁸

Vlen të përmendet se çmimi total i kontratës është 403,204.56€ për 24 muaj. Ky tejkallim i kësaj vlere të parashikuar **bie ndesh me nenin 17 të LPP-së**.

Po ashtu AK nuk është deklaruar se ka bërë përmirësim në Dosjen e Tenderit sa i përket vlerës së parashikuar, pasi kjo nuk është e identifikuar në asnjë njoftim qoftë edhe përmes formularit B54 “Njoftim për informata shitesë” ose “Përmirësim i gabimit”. Ndërkaq, sipas zyrtarit të përgjegjës të prokurimit në Ferizaj, rritja e vlerës së parashikuar të kontratës ka ardhur si rezultat i kërkesave të operatorëve ekonomik të interesuar për këtë tender.²⁹ LPP nuk e parasheh që kërkesat e OE-ve të përcaktojnë vlerën e parashikuar të kontratave.

AK ka bërë shkelje edhe të nenin 28 të LPP, pasi në dosjen e tenderit nuk janë parashtruar specifikimet teknike të detyrueshme. AK nuk ka specifikuar fushëveprimin e kontratës, duke përcaktuar se (i) çfarë detyrash kryesore kanë punonjësit e sigurimit fizik, (ii) sa do të jetë numri i vend-qëndrimeve të tyre, (iii) sa do të jetë numri i punonjësve në një vend-

²⁶ Raporti i Vlerësimit, i nënshkruar më 12.12.2018, i siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike.

²⁷ Planifikimi i Prokurimit 2018, i qasshëm në: <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/category/prokurimi/plani-i-prokurimit/?page=2018>

²⁸ Dosja e tenderit, e qasshme në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=327>

²⁹ INPO intervistë me zyrtarin përgjegjës të prokurimit në Komunën e Ferizajt, z. Fehmi Reka. 28.02.2019

qëndrim, (iv) sa do të jetë numri i orëve të nevojshme për sigurimin fizik të një objekti AKI, (v) çfarë llojesh të kontrollave duhet të kryejnë, etj.³⁰

Duke u nisur nga kjo, edhe përshkrimin i çmimeve të publikuara në e-prokurim për këtë aktivitet të prokurimit nuk shpjegon në mënyrë të qartë dhe kuptueshme mënyrën se si duhet llogaritur numri i orëve të sigurimit dhe numri i punonjësve nëpër pika të qëndrimit. Respektivisht, AK nuk ka specifikuar numrin e orëve ditore të nevojshme për sigurim fizik të një objekti, por ka vendosur vetëm orët mujore të nevojshme.

Sipas një kalkulimi të thjeshtë, INPO gjen se komuna ka llogaritur në mënyrë jo reale numrin e orëve të nevojshme për sigurim.

Nëse pjesëtojmë 1080 orë mujore për sigurimin e objektit të komunës me 30 ditë kalendarike, na jep 36 orë ditore. Rrjedhimisht, dita i ka 24 orë, ndërkaq komuna paguan për 36 orë sigurimin për një ditë.

$1080 \text{ orë mujore} / 30 \text{ ditë} = 36 \text{ orë ditore.}$

Në rastin tjetër, komuna ka kërkuar 1981 orë mujore për sigurimin e katër (4) objekteve të QKMF-së.

$1981 \text{ orë mujore} / 4 \text{ objekte} = 495.25 \text{ orë mujore për një objekt.}$

$495.25 \text{ orë mujore për objekt} / 30 \text{ ditë kalendarike} = 16.50 \text{ orë ditore}$

Përshkrimi i Shërbimit	Totali i orëve për muaj
Sigurimi fizik për objektin e Komunës	1080 h
Sigurimi fizik për objektin e Komunës – objekti i ish Gjykatës Komunale	1080 h
Sigurimi fizik për 4 objekte të QKMF-së	1981 h
Sigurimi fizik për Qendrën e Shërbimit Emergjent Primar	720 h

Tabela 3: Lista e çmimeve.

Në dokumentin e përshkrimi të çmimeve, AK ka vendosur kusht për OE fitues që t'i pranojë në punë ish-punëtorët e Komunës, QKMF-së dhe objekteve, të cilat funksionojnë në kuadër të Komunës së Ferizajt, të cilët kanë qenë punëtorë të përhershëm në këto institucione, numri i të cilëve është 25 punëtorë, plus dhe nëntë (9) punëtorë të tjerë ku në gjithsej numri i punëtorëve duhet të jetë 34 punëtorë. Paga për një punëtorë është përcaktuar nga AK në shumë prej 270€ Neto.

³⁰ Aneksi I – Specifikat teknike të detyrueshme: Dosja e Tenderit, i qasshëm në www.e-prokurimi@rks-gov.net

Në Njoftimin për Kontratë të publikuar më 17.09.2018, tek Kushtet për Pjesëmarrje, AK nuk ka vendosur asnjë kërkesë për kapacitet ekonomik dhe financiar dhe për atë teknik dhe profesional të OE. Më pas vetëm dy (2) ditë para se të bëhej Hapja e Ofertave, AK përmes publikimit të formularit standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, ka ndryshuar në mënyrë esenciale kushtet për pjesëmarrje në tender, duke vendosur 14 kërkesa të reja.³¹

Ky përmirësim është bërë saktësisht 40 ditë pas publikimit të njoftimit për kontratë dhe vetëm dy (2) ditë para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve.³²

INPO vlerëson se kjo ka rezultuar që AK të mos bëjë saktë edhe kalkulimin e vlerës së parashikuar të kontratës dhe të mos specifikojë në mënyrë të qartë fushëveprimin e saj, duke devijuar nga parimi i ekonomicitetit dhe efikasitetit të prokurimit si dhe trajtimit të barabartë dhe mos diskriminimit të OE.

Tutje, sipas raportit të vlerësimit³³ të gjithë OE përveç fituesit janë eliminuar për shkak të mospërbushjes së kërkesës për kapacitet teknik dhe profesional, respektivisht, ofrimin e dëshmive të kënaqshme për kryerjen e shërbimeve në lëmin e kontratës në tri vitet e fundit, jo më pak se 250 mijë euro. Ndërsa, në ndryshimet që kanë ndodhur me Formularin B54 ku AK ka bërë përmirësimin e gabimeve apo informacioneve shtesë kjo vlerë është rritur në 375,000,00€.

Për këtë tender, oferta kanë dorëzuar vetëm dy (2) OE. Gjatë procesit të vlerësimit të ofertave OE “NAZERI 2000”, i cili kishte ofertuar me çmimin më të lirë, është shpallur i papërgjegjshëm. Grupi i OE “Skyfterat-Live”, “Comando”, “Group For Security” dhe “Zona Park”, sipas raportit të vlerësimit ka qenë i përgjegjshëm dhe është shpërblyer me kontratë.

Tenderuesi	Çmimi me TVSH për 24 muaj	Statusi pas Vlerësimit
“NAZERI 2000” Sh.P.K.	296,567.04€	Eliminuar
Grupi i OE “Skyfterat-Live” Sh.P.K., “Comando” Sh.P.K., “Group For Security” Sh.P.K.” dhe N.Sh.H. “Zona Park”	403,204.56€	Fitues i kontratës

Tabela 4. Lista e OE ofertues dhe statusi i tyre pas vlerësimit të tenderëve.

³¹ **Shënim:** Sipas dosjes së tenderit hapja e ofertave do të bëhej me 24.10.2018, ndërsa publikimi i Formularit Standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara është bërë më 22.10.2018.

³² Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, i publikuar më 22.10.2018 në sistemin elektronik (shih linkun: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=327>).

³³ Raporti i vlerësimit, i datës 25.10.2018, i siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike

Gjithashtu, AK ka bërë shkelje të njëpasnjëshme të LPP, gjatë vendosjes së afateve për validitetin e tenderit, periudhën e vlefshmërisë së sigurisë së tenderit, si dhe periudhën e sigurimit të ekzekutimit të kontratës.³⁴

Pas publikimit të njoftimit për vendimin e komunës për rezultatet e tenderit, OE “Nazeri 2000” ka parashtruar **Kërkesë për Rishqyrtim** në AK, ndërkaq AK i ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim duke e vlerësuar si të pabazë.

Më 09.11.2018, OE parashtron ankesë³⁵ në OSHP me pretendimin se AK ka bërë shkelje të nenin 59 dhe 72 të LPP si dhe nenit 39 të RrOUPP. Sipas vendimit të panelit shqyrtues të OSHP-së PSh.644/2018, OE ankues është eliminuar me të drejtë nga tenderi pasi nuk i ka sjellë dëshmitë e kërkuara sipas dosjes së tenderit, respektivisht Certifikatat ISO i ka sjellë pa vulë noteriale.

Mirëpo, sipas nenit 39.5 të RrOUP, AK mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-së. Madje, për këtë janë shembujt e paraqitur në faqen 81 të RrOUP, për mënyrën se si duhet të veprojë autoriteti kontaktues ndaj problemeve të paraqitura, për **Mungesën e Certifikatës ISO, AK mund të kërkojë informata sqaruese** sipas nenit **69 të LPP**.

Kësisoj, OE ankues, ka dorëzuar Certifikatat ISO të kërkuara në dosje, por të njëjtat nuk kanë qenë të noterizuara. Rrjedhimisht, AK është dashur që të kërkojë nga OE që brenda një afati të arsyeshëm kohorë të sjellë certifikatat me vulë noteriale.

Pavarësisht, (mos) veprimeve të komunës, OSHP është dashur që të marr për bazë mendimin e ekspertit,³⁶ i cili ka rekomanduar që lënda të kthehet në rivlerësim.

Tutje, komuna nuk ka bërë publikimin e *njoftimit për dhënie të kontratës, kontratën dhe deklaratën e nevojave dhe disponueshmërisë së mjeteve*.

³⁴ *Shënim:* AK ka bërë shkelje të dispozitës ligjore të prokurimit publik, respektivisht të nenit 31 të RRUOPP, pasi periudha e validitetit të tenderit për këtë aktivitet të prokurimit me vlerë të madhe duhet të jetë 90 ditë. Ndërsa AK në Njoftimin për Kontratë si dhe në Dosjen e Tenderit ka kërkuar që ky validitet të jetë 60 ditë. Po ashtu, kjo bien ndesh edhe kërkesën tjetër të Komunës ku kërkon që vlefshmëria e sigurisë së tenderit të jetë 120 ditë. Kjo është në kundërshtim me nenin 29.6 i cili citon “Sigurimi i tenderit do të qëndroj valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas skadimit të periudhës së validitetit të tenderit.” Po ashtu, AK nuk ka vendosur periudhën e kohëzgjatjes së sigurisë së ekzekutimit konform kërkesave të Dosjes së Tenderit, nenit 63 të LPP-së, si dhe nenit 30.6 të RrUOPP “Sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës”

³⁵ Ankesa nr.644/18, e qasshme në: <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/644-18ankesa.PDF>

³⁶ Akt përcjellës, Lënda: Raporti i ekspertit shqyrtues, i qasshëm në <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/644-18eksp.pdf>

Administrimi i profilit të kryetarit të komunës në rrjetet sociale

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar sipas procedurës së negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë dhe kontrata është lidhur në vlerë prej 18 mijë Euro me OE “Shëndet Aliu”.

INPO ka analizuar kontratën dhe dokumentet relevante dhe ka gjetur se AK, nuk e ka plotësuar asnjë kusht ligjor për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë.

Sipas analizës së dokumenteve, inicimi i aktivitetit të prokurimit me procedurë të negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë, nuk ka qenë i natyrës së urgjencës ekstreme dhe shërbimet të cilat janë kontraktuar nuk klasifikohen si shërbime sipas të drejtave ekskluzive, pasi që shërbimet e fotografimit, video-incizimeve, menaxhimi i profileve online dhe shërbimeve tjera të kësaj natyre, mund të gjenden me bollëk në tregun e Republikës së Kosovës.

Tutje, tenderi nuk ka qenë i planifikuar në Planifikimin Përfundimtar të Prokurimit dhe as në Buxhetin e Komunës për vitin 2018.

Ndërkaq, sipas Raportit Vjetor për Kontratat e Nënshkruara Publike për vitin 2018, e gjitha proceduara nga faza e inicimit të aktivitetit të prokurimit, negocimit e deri tek lidhja e kontratës komunës ka kaluar për vetëm shtatë (7) ditë. Tutje, në këtë raport komuna ka bërë deklaram të rremë, pasi ka deklaruar se kjo kontratë është lidhur sipas procedurës së hapur dhe ka shënuar edhe datat e publikimit të njoftimit për kontratë dhe njoftimit për dhënie të kontratës, ndërkaq në platformën e-prokurimi, nuk mund të gjendet asnjë lloj njoftimi e publikuar rreth kësaj kontrate. Sipas raportit, publikimi i njoftimit për kontratë është bërë më 22 prill 2018, që sipas kalendarit kjo datë ka qenë ditë e diele.

Në deklaratën e nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve mungon numri i prokurimit për të cilin është zhvilluar procedura, mungon konstatimi i saktë se si ky prokurim do të përmbushë objektivat institucionale të komunës, dhe mungon numri i Urdhërësës së Zotimit dhe Pagesës. Po ashtu, kjo deklaratë nuk është e nënshkruar nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, Kryetari i Komunës dhe nga Zyrtari Kryesor Financiar.

Për këtë tender AK nuk ka hartuar dosje. Neni 27 i LPP-së, obligon komunën që të përpilojë një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termat dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë apo kriteret e përzgjedhjes, procedurat e ankesës etj.

Raporti i vlerësimit të tenderëve nuk ofron asnjë lloj të dhëne rreth mënyrës së vlerësimit të përshtatshmërisë dhe kapacitetit të ofertuesit për të ofruar shërbimet. Sipas këtij raporti çmimi total i ofertës është 750€. Po ashtu, në njoftimin Nr.01-51/2018 të

komisionit negociues drejtuar Zyrtarit të Prokurimit, thuhet se pas negociatave është arritur marrëveshja që vlera e këtij shërbimi të jetë 750€, nga 810 të ofruar sa ishte ofertuar nga ana e kompanisë. Sipas këtij dokumenti çmimi total i kontratës është dashur të jetë 750€. Mirëpo sipas kontratës, 750€ do të jetë shuma mujore që do të paguhet përgjatë 24 muajve nga data e lidhjes së kontratës, e që në total vlera e kontratës është 18 mijë euro.

Në anën tjetër, përveç shkeljeve ligjore gjatë zhvillimit të kësaj procedure, INPO ka gjetur OE “Shëndet Aliu B.I” është themeluar vetëm dy (2) muaj para se të shpërblehej me kontratë.³⁷ Pronar i kësaj kompanie është Shëndet Aliu, i cili ka lidhje familjare me Lulzim Aliun, drejtori i Urbanizimit në Komunën e Ferizajt.

Pas reagimit publik të INPO-s, AK më 15.02.2019 me marrëveshje ka shkëputur këtë kontratë.³⁸ Shkëputja e kontratës nuk është publikuar nga ana e AK, me arsyetimin se tashmë kjo kontratë është objekt i procedurës hetimore.³⁹ Organet e rendit asnjëherë nuk e kanë kontaktuar INPO-n rreth gjetjeve të tenderit, dhe deri më tani nuk janë vërejtur veprime të PTH në Ferizaj rreth këtij hetimi.

³⁷ <http://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=1,38,162851>

³⁸ Marrëveshje për ndërprerjen e kontratës, nr01K – 04, e siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike.

³⁹ Përgjigje zyrtare përmes postës elektronike e Zyrtarit për Qasje në Dokumente Publike të komunës së Ferizajt, më 1 korrik 2019.

Gjetjet në aktivitetet e prokurimit në Junik

Tenderët e monitoruar të komunës së Junikut, shpërfaqin dobësitë e komunës në hartimin dhe publikimin e letrave standarde për OE të eliminuar ose të pasuksesshëm. Në njërin tender komuna nuk i kishte publikuar listat standarde përkundër obligimit ligjor, ndërsa në tenderin tjetër nuk i ka shënuar arsyet reale të eliminimit të OE-ve në bazë të raportit të vlerësimit.

Mirëmbajtja dhe servisimi i pajisjeve mjekësore

Për këtë kontratë komuna nuk e kishte publikuar njoftimin mbi vendimin e AK sipas rregullave. Në këtë njoftim nuk janë bashkangjitur letrat standarde përmes së cilave njoftohen OE për rezultatin e ofertave të tyre.

Për këtë tender një OE kishte deponuar ankesë në OSHP, pasi i ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim. Kësisoj, komuna nuk ka bërë pezullimin e këtij aktiviteti të prokurimit ashtu siç kërkohet me rregulla, duke mos e publikuar atë.⁴⁰ Po ashtu, nuk ishte bërë publikimi i vendimit të AK lidhur me kërkesën për rishqyrtim të ushtruar nga OE ankues.⁴¹

Kontrata me OE. “Buli-Medical”, me çmim prej 1,890€ ishte nënshkruar pa pasur ndonjë vendim nga OSHP, rreth ankesës së OE ankues. Paneli Shqyrtues i OSHP më 08.08.2019⁴² merr vendim në favor të palës ankuese, ndërkaq komuna kishte nënshkruar kontratën më 27.06.2019. Po ashtu, AK nuk e ka publikuar kontratën e nënshkruar.

Hapja e rrugëve fushore në Komunën e Junikut

Nënshkrimi i kësaj kontrate është bërë më 09.07.2019 me OE “JOOS&KRASNIQI-BAZË” dhe “Q SHALA” në vlerë prej 112,270.60€. Sipas dispozitave të kësaj kontrate kohëzgjatja e saj është tre (3) muaj.

Në kohën e përgatitjes së tenderit, rezulton se AK nuk i kishte hartuar kushtet e veçanta të kontratës.

AK ka bërë shkelje të nenit 54 të LPP-së, pasi në bazë të raportit të vlerësimit të ofertave⁴³ disa tenderues nuk i kishin plotësuar kërkesat e njoftimit për kontratë dhe të Dosjes së Tenderit dhe këta tenderues AK nuk i ka shpallur të eliminuar dhe nuk Ju ka shpjeguar shkaqet për eliminimin e tyre, por në Letrat Standarde për njoftimin e

⁴⁰ Shih linkun <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=327>

⁴¹ Po aty.

⁴² Vendimi i OSHP-së: <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2019/310-19vend.pdf>

⁴³ Raporti i vlerësimit të ofertave, i siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike.

Tenderuesve/Kandidatëve i ka shpallur të pasuksesshëm.⁴⁴ As kjo kontratë nuk është publikuar.

Gjetjet në aktivitetet e prokurimit në Klinë

Komuna e Klinës ka treguar bashkëpunim në adresimin e disa gjetjeve të INPO-s gjatë fazës tenderuese. Megjithatë, kontaktimi i punëve pa mjete të mjaftueshme në dispozicion, dhe vonesat në vlerësimin e tenderëve është gjetur si probleme që duhet të adresohen nga kjo komunë.

Asfaltimi i Rrugëve lokale: Budisalc, Stup, Siqevë, Qeskov, Gjurgjevik i Vogël

Organizata Jo-qeveritare, Iniciativa për Progres “INPO” ka bërë monitorimin e aktivitetit të prokurimit, të cilin e zhvillon Komuna e Klinës me titull: *“Asfaltimi i Rrugëve Lot 1-Rrugëve lokale Budisalc, Lot 2-Rrugëve lokale Stup, Lot 3-Rrugëve lokale Siqevë, Lot 4-Rrugëve lokale Qeskov, Lot 5-Rrugëve lokale Gjurgjevik i vogël”* me nr. të prokurimit 634-19-636-5-2-1, shpallja e të cilit është bërë më 04.03.2019. Gjatë monitorimit të këtij aktiviteti të prokurimit, INPO ka vërejtur disa lëshime, të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e LPP-së:

Në mars 2019, AK përmes procedurave të hapura kishte filluar prokurimin për këtë tender. Tenderi ishte i ndarë në pesë (5) lote me vlerë të parashikuar si në vijim:

Lot 1 - 48,000.00€,

Lot 2 - 55,000.00€,

Lot 3 - 75,000.00€,

Lot 4 - 120,000.00€,

Lot 5 - 145,000.00€.

Mirëpo, AK nuk i kishte plotësuar kërkesat e nenit 9 të LPP-së, me rastin e lidhjes së kësaj kontrate, duke mos pasur në dispozicion të gjitha mjetet për këtë aktivitet të prokurimit. Sipas kësaj dispozite, para çdo fillimi të një aktiviteti të prokurimit duhet të ketë një vlerësim formal të nevojave. Duke u bazuar në planifikimin përfundimtar të prokurimit për vitin 2019 të AK-së, si dhe Ligjit për Ndarjet Buxhetore për vitin 2019, planifikimi ka qenë si në vijim:

Lot 1 - 30,000€

Lot 2 - 40,000€

Lot 3 - 50,000€

Lot 4 - 60,000€,

⁴⁴ Letrat standarde, të qasshme në <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=327>

Lot 5 - 120,000€.

Interpretimi i publikuar i KRPP-së më 30.03.2017 me numër 133/2017, thotë se: *“Para inicimit të cilit do aktivitet prokurimi duhet përmbushur saktësisht kërkesat e nenit 9 të LPP-së. Mos përmbushja e të gjitha kërkesave (paragrafëve) nga neni i cekur me lart përbën shkelje serioze të dispozitave të LPP-se dhe legjislacionit dytësor për prokurim publik si dhe të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike”.*

Komuna e Klinës ka në njoftimin për kontratë ka vendosur si kusht të veçantë që *“Me vendim të Komunës, OE që kanë projekte të papërfunduara me Komunën nuk do të shpërblehen me kontratë të re”.* Aplikimi i këtij kriteri nga AK, rezulton të jetë **në kundërshtim edhe me nenin 7, paragrafi 4 i LPP-së**, i cili i ndalon AK-të të krijojnë apo imponojnë krijimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

Ndërtimi i Kanalizimeve: Ranoc-Leskoc, Dresnik, Dolc dhe në lagje të Klinës

Publikimi i tenderit është bërë më 01.05.2019. Menjëherë pas publikimit INPO më 02.05.2019 ka reaguar rreth disa lëshimeve të cilat kanë qenë në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, dhe për të cilat Komuna e Klinës një pjesë të tyre i ka adresuar. Në vijim janë rekomandimet e INPO-s rreth gjetjeve dhe përgjigjet e komunës:

1. Gjetja dhe rekomandimi i INPO: Kërkesa e Përshtatshmërisë e vendosur në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosje të Tenderit *“Vërtetimi që nuk ka obligime të pashlyera në Komunë”* **nuk është kërkesë e nenit 65 të LPP-së, dhe nenit 26 të RRUOPP. Andaj, me qëllim që të mos jeni në kundërshtim me këto dispozita, kërkojmë që kjo kërkesë të largohet.**

Këtë rekomandim Komuna e Klinës nuk e ka adresuar.

2. Gjetja dhe rekomandimi i INPO: Nuk është vendosur drejtë periudha e kohëzgjatjes së sigurisë së ekzekutimit konform kërkesave të nenit 63 të LPP-së, si dhe nenit 30.6 të RRUOPP-së ku kërkohet Sigurimi i ekzekutimit të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës. Ndërsa, në rastin tuaj, keni kërkuar *“Plani dinamik +30 ditë”.* Po ashtu, *kërkojmë që të bëhet përmirësimi i kësaj kërkesë dhe sigurimi i ekzekutimit të mos lidhet me planin dinamik, por me përfundimin e kontratës.*

Këtë rekomandim Komuna e Klinës e ka adresuar dhe e ka bërë përmirësimin.

3. Gjetja dhe rekomandimi i INPO: Afati për përfundimin e kontratës ka qenë i paqartë (60 muaj).

Komuna e Klinës e ka adresuar dhe ka bërë përmirësimin.

Me rastin e nënshkrimit të kontratave për secilin LOT, INPO ka kërkuar qasje në dokumente publike për këtë aktivitet të prokurimit, me ç'rast ka bërë monitorimin që

nga koha e inicimit të aktivitetit e deri në nënshkrim të kontratës. Në këtë pjesë të tenderimit, nuk kemi evidentuar ndonjë të gjetur tjetër.

Asfaltim i rrugëve: Dollovë, Grabanicë, Dush, Jellovc

Njëjtë është vepruar edhe në këtë tender. Ku disa nga gjetjet dhe rekomandimet e INPO-s janë adresuar nga komuna.

1. Gjetja dhe rekomandimi i INPO: Kërkesa e Përshtatshmërisë e vendosur në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosje të Tenderit “Vërtetimi që nuk ka obligime të pashlyera në Komunë” nuk është kërkesë e nenit 65 të LPP-së, dhe nenit 26 të RRUOPP. Përveç kësaj, kjo është në kundërshtim edhe me nenin 51 të LPP-së
Këtë rekomandim, Komuna e Klinës nuk e ka adresuar.
2. Gjetja dhe rekomandimi i INPO: Në Njoftimin për Kontrate dhe në Dosjen e Tenderit të publikuar më 13.05.2019, afatin për pranimin e tenderëve është vendosur deri më 30.05.2019. Kjo është **në kundërshtim me nenin 44, paragrafit 2 dhe paragrafit 2.2 të LPP-së**, për shkak se janë lënë në dispozicion vetëm 18 ditë për të ofertuar dhe në njoftimin nuk është e evidentuar se është bërë shkurtim afati, apo ndonjë arsyetim për këtë shkurtim të afatit.

Ky rekomandim është adresuar dhe është bërë përmirësimi.

Pas nënshkrimit të kontratave, INPO ka kërkuar qasje në dokumente publike për këtë aktivitet të prokurimit, me ç’rast ka bërë monitorimin që nga koha e inicimit të aktivitetit e deri në nënshkrim të kontratës. Në këtë pjesë të tenderimit, INPO ka evidentuar procesi i vlerësimit të tenderëve kishte filluar 20 ditë pas hapjes së ofertave.

Gjetjet në aktivitetet e prokurimit në Ranillug

Komuna e Ranillugut kishte adresuar gjetjet dhe rekomandimet e INPO-s gjatë fazës tenderuese të njërit nga tenderët e monitoruar. Megjithatë, INPO në tenderin tjetër ka gjetur se komuna ka përdorur kritere diskriminuese, duke kërkuar që OE të mos jetë më larg se 15 km nga objekti i komunës. Po ashtu, mospublikimi i dokumenteve të prokurimit të cilat sipas ligjit duhet të publikohen është një shkelje tjetër që INPO ka evidentuar.

Ndërtimi i sallës së fiskullturës për shkollën fillore “Trajko Periq” në Ropotovë të Madhe

INPO për këtë tender kishte komunikuar me komunën më qëllim të përmirësimit të gabimeve në dokumentet e publikuara gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit.

Gjetjet e evidentuara, gjegjësisht kërkesave diskriminuese që kanë ndodhur e të cilat kanë qenë në kundërshtim me dispozitat e LPP-së si dhe përgjigjet e komunës janë si në vijim:

1. Gjetja dhe rekomandimi i INPO: Numri i brendshëm i prokurimit i vendosur në këtë aktivitet të prokurimit është në kundërshtim me paragrafin 2, të nenit 16 të RrUOPP.

Këtë gjetje, Komuna e ka adresuar dhe ka bërë përmirësimin e duhur.

2. Gjetja dhe rekomandim i INPO: Kërkesa e gjendjes ekonomike dhe financiare si dhe kërkesa mbi mundësit teknike dhe profesionale, sa i përket tri viteve të fundit (2016, 2017, 2018) është në kundërshtim me nenin 26, paragrafi 8 të RRUOPP-së. Po ashtu, edhe me interpretimin e KRPP-së të dt.06.12.2017, në të gjitha rastet e përfshira në paragrafin 1 të nenit 68, paragrafëve 2.1, 4.2 dhe 6.2 të nenit 69 përmendet shprehja si në vijim citojmë: “.....të realizuara në tri vitet e shkuara “ose “...në periudhën e shkuar trevjeçare...”). Në kuptimin e Ligjit, shprehja “tri vitet e shkuara” nënkupton: “Periudhën kohore të përcaktuar në këto nene, e cila ndërlidhet me periudhën që paraprinë datën e publikimit të njoftimit për kontratë. Andaj, kur do që përmendet vitet e shkuara apo të fundit si në rastin tuaj, llogaritje e këtyre viteve të ndërlidhet me datën e publikimit të njoftimit për kontratë.”

Këtë të gjetur Komuna e ka adresuar dhe ka bërë përmirësimin e duhur.

3. Gjetja dhe rekomandim i INPO: Kërkesa minimale e kualifikimit e vendosur në Dosjen e Tenderit “Plani dinamik deri 100 ditë kalendarike” nuk është kërkesë e nenit 69 të LPP-së, dhe nenit 26 të RRUOPP. Përveç kësaj, kjo është në kundërshtim edhe me nenin 51 të LPP-së, paragrafi 1, i cili përcakton se: “Në asnjë rast, autoriteti kontraktues, nuk duhet të përfshijë, saktësojë ose përdorë kritere të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera, përveç atyre të lejuara nga

dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji”. Përveç kësaj, kjo kërkesë nuk është edhe në njoftimin për kontratë, që i bie të jetë në kundërshtim me nenin 27, paragrafi 4, i LPP-së, i cili përcakton se: “Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike”.

Këtë të gjetur të Komuna e ka adresuar dhe ka bërë përmirësimin e duhur.

4. Gjetja dhe rekomandim i INPO: Nuk është vendosur drejtë periudha e kohëzgjatjes së sigurisë së ekzekutimit konform kërkesave të **nenit 63 të LPP-së, si dhe nenit 30.6 të RRUOPP-së**. Komuna ka kërkuar që kjo periudhë të jetë aq sa është kohëzgjatja e kontratës pesë (5) muaj, ndërsa ligjërisht kërkesa për sigurim të ekzekutimit në këtë rast duhet të jetë në kohëzgjatje prej 6 muaj (5 muaj + 30 ditë).

Këtë të gjetur Komuna e ka adresuar dhe ka bërë përmirësimin e duhur.

5. Gjetja dhe rekomandim i INPO: Kërkesa e vlerës së sigurisë së tenderit prej 1,000€, është në kundërshtim me nenin 57, paragrafi 3 i LPP-së, i cili udhëzon AK-të që shuma e sigurisë së tenderit duhet të jetë jo më pak se një për qind (1%) dhe jo më shumë se tre për qind (3%) e vlerës së parashikuar të kontratës publike ose konkursit të projektimit, por sidoqoftë, në asnjë rast nuk duhet të jetë më pak se njëmijë (1,000) Euro”. Kësisoj, për tenderin me vlerë të parashikuar prej 175,217.96€, vlera e sigurisë së tenderit duhet të jetë 1,752€. Po ashtu, rekomandime janë dhënë edhe për periudhën e validitetit të sigurimit të tenderit.

Këtë të gjetur Komuna e ka adresuar dhe ka bërë përmirësimin e duhur.

Pas nënshkrimit të kontratës më 20.06.2019 nga ana e Komunës dhe OE fitues N.N.P.T. “Engineering” me çmim prej 145,085.65€, INPO ka kërkuar qasje në dokumente publike për këtë aktivitet të prokurimit, me ç’rast ka bërë monitorimin që nga faza e hapjes së tenderëve deri në nënshkrim të kontratës. Gjetjet tjera, gjatë kohës së zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit, janë:

1. Komuna e Ranillugut, ka bërë shkelje të dispozitave të prokurimit publik konkretisht nenin 18.3 të RRUOPP, duke mos plotësuar Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK), në kohën e përgatitjes së Dosjes së Tenderit. Disa pjesë të plotësuar në KVK, nuk janë për këtë aktivitet të prokurimit sidomos caktimi i menaxherit të kontratës dhe Planit Dinamik.
2. Nuk është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK së bashku me letrat standarde.
3. Nuk është saktësuar data e implementimit të kontratës por kohëzgjatja e kontratës është dhënë me ditë (150).
4. Nuk është publikuar lista e çmimeve dhe kontrata.

Furnizim me ushqime dhe produkte higjienike

Kriteret e tenderit për furnizim, me vlerë të parashikuar të kontratës 19,937.60€, ishin diskriminuese dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore për prokurim publik.

Tek kapaciteti teknik dhe profesional, AK kishte kërkuar që OE (i) të sigurojnë dëshmi se kanë të kryera obligimet ndaj 4 punonjësve në tremujorin e parë të vitit 2018, (ii) EO nuk duhet të gjendet më shumë se 15 km nga ndërtesa komunale.⁴⁵

Tutje, kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë nuk ishin identike, meqenëse është evidentuar se kërkesa “OE nuk duhet të gjendet më shumë se 15 km nga ndërtesa komunale”, është në njoftimin për kontratë, ndërsa në Dosjen e Tenderit nuk është.⁴⁶

Brenda afatit ligjor komuna kishte publikuar formularin B54 – “Njoftim për informata shitesë/përmirësim gabimi”, me ç’rast kishte vendosur kërkesa edhe sa i përket kapacitetit ekonomik dhe financiar, të cilin nuk e kishte përfshirë në raportin e vlerësimit. Pra, tenderët janë vlerësuar, duke mos e marr në konsideratë kërkesën për kapacitet teknik dhe profesional.⁴⁷

Në kohën e përgatitjes së Dosjes së Tenderit nuk janë plotësuar Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Në këtë tender kishin ofertuar tre (3) OE, ndërkaq OE fitues ishte “Igball Ajvazaj B.I. – N.T.P. Lanti Besa”, me çmim prej 19,668.50€.

⁴⁵ Shënim: AK, nuk duhet të përfshijë, saktësojë ose përdorë kriteret të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera, përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të LPP-së.

⁴⁶ Dosja e tenderit, e qasshme në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=327>

⁴⁷ Shënim: Kjo është në kundërshtim me parimet kryesore të procedurës së vlerësimit sipas LPP-së, respektivisht nenit 59.

Gjetjet në aktivitetet e prokurimit në Malishevë

Në tenderin e monitoruar INPO ka gjetur se komuna ka bërë kufizimin e numrit të referencave përmes të cilave OE duhet të dëshmojnë kapacitetin e tyre teknik dhe profesional, Kjo ka rezultuar edhe në eliminimin e tre (3) OE si pasojë e kriterëve kufizuese.

Renovimi i objekteve shkollore, çerdhes publike dhe sallës së sportit në Malishevë

Në këtë tender fitues është shpallur “SINANI-ING” SHPK me çmim prej 288,819.36€. Sipas dispozitave të kësaj kontrate kohëzgjatje e saj është 250 ditë pune, por nuk është saktësuar afati i përmbylljes së kontratës.

Tek kërkesat minimale të kualifikimit në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosje të Tenderit AK kishte vendosur disa kërkesa diskriminuese, duke e kufizuar numrin e kontratave për punë të ngjashme në minimum tri (3) kontrata. OE ishin lejuar të sjellin edhe më shumë se tri (3) kontrata, vlera e të cilave kontrata duhet të ishte jo më e vogël se 370,000€. Kufizimi në minimum tri (3) kontrata është në kundërshtim me nenin 69 të LPP-së. Në bazë të kësaj, Komuna e Malishevës nuk ka të drejtë të bëjë kufizimin e numrit të referencave. E rëndësishme për AK është që të sigurohet se OE përmbushin vlerën minimale, e cila është kërkuar pavarësisht numrit të referencave. Po ashtu edhe me kërkesat tjera sa i përket Çertifikatave ndërkombëtare, duke kërkuar një numër të madh të tyre, ndoshta edhe të panevojshme, për shkak të natyrës së punëve por edhe duke i përsëritur kërkesat (nr. 11 dhe 13) dhe njërin prej tyre është kërkesë që të jenë të çertifikuar tre (3) inxhinier.⁴⁸

Këto veprime në mënyrë të drejtpërdrejte krijojnë pabarazi në mesin e OE. Këtë e vërteton fakti se edhe interesimi i OE për këtë tender,⁴⁹ ka qenë shumë i madh, ndërsa vetëm pesë (5) oferta janë dorëzuar. Prej tyre, tri (3) janë eliminuar për shkak të këtyre kërkesave, dy (2) prej tyre ofertave të eliminuara kanë qenë më të lira se sa oferta fituese. Njëra për 90,336.36€, ndërsa tjetra për 31,639.16€.

⁴⁸ Dosja e tenderit, e qasshme në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=327>

⁴⁹ Lista e OE të interesuar, e siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike

Gjetjet në aktivitetet e prokurimit në Mitrovicë të Jugut

Vendosja e kriterëve diskriminuesë dhe mos hartimi i specifikimeve të detyrueshme teknike rezultojnë të gjetura në komunën e Mitrovicës së Jugut. Po ashtu, korrigjimi i gabimeve në njoftimet e publikuara në kundërshtim me ligjin është evidentuar në këtë komunë.

Ndërtimi dhe vendosja e shkallëve Emergjente në disa objekte shkollore

Në kërkesat minimale të kualifikimit në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosje të Tenderit, AK kishte vendosur disa kërkesa diskriminuese, duke e kufizuar numrin e kontratave për punë të ngjashme në minimum tri (3) kontrata ose referenca, të cilat ndikojnë në kufizim të konkurrencës së lirë dhe bënë diskriminim të OE.

Përmbajtja e njoftimit për kontratë dhe dosja e tenderit nuk ishte identike me njëra tjetrën pasi që në dosjen e tenderit nuk ishte kërkuar siguria e tenderit. Po ashtu validiteti i sigurimit të ekzekutimit të kontratës nuk ishte sipas ligjit. Të gjitha këto gjetje, i janë adresuar me kohë komunës nga INPO, e cila ka bërë përmirësimin e tyre brenda afateve ligjore.

Pas nënshkrimit të kontratës, komuna nuk ka përgatitur njoftimin për nënshkrim, si dhe nuk ka publikuar kontratën.

Furnizimi, vendosja dhe montimi i semaforëve dhe mirëmbajtja tri vjeçare e tyre

Edhe në këtë tender janë vendosur kërkesa diskriminuese, duke e kufizuar numrin e kontratave për punë të ngjashme në minimum tri (3) kontrata ose referenca të punëve të njëjta në vlerë minimum 285,000.00€ tri (3) vitet e fundit. Tutje, AK kishte kërkuar edhe shtatë (7) lloje të certifikatave ISO.⁵⁰ INPO ka gjetur se **ISO 14001: 2004** - e cila specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor, është shfuqizuar dhe zëvendësuar me ISO 41001: 2015.⁵¹

AK kërkesën për minimum tri (3) kontrata ose referenca të punëve të njëjta në vlerë minimum 285,000.00€ tri (3) vitet e ka përmirësuar përmes Njoftimin Standard Formulari për informata shtesë dhe për përmirësimin e gabimeve, por ky përmirësim nuk ka pasur efekt ngase publikimi i këtij njoftimi është bërë në ditën e njëjtë kur është bërë hapja e ofertave më 01.04.2019 dhe nuk e ka zgjatur afatin për tenderim.⁵²

⁵⁰ Dosja e tenderit, e qasshme në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=327>

⁵¹ Shih linkun:

https://www.iso.org/search.html?q=ISO%2014001%3A%202004&hPP=10&idx=all_en&p=0&hFR%5Bcategory%5D%5B0%5D=standard

⁵² Formulari për informata shtesë dhe për përmirësimin e gabimeve, i qasshëm në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=327>

Rrjedhimisht, me këto kërkesa është bërë kufizimi i konkurrencës së lirë dhe diskriminimi i OE. Kjo është vërtetuar edhe nga fakti se për këtë aktivitet të prokurimit është paraqitur vetëm një ofertë, në krahasim me listën e OE të interesuar për këtë aktivitet të prokurimit.

Tutje, AK nuk ka vendosur specifikimet teknike dhe të detyrueshme në Dosjen e Tenderit, konform nevojave për të cilat ka nevojë për furnizim, qoftë edhe përmes vizatimeve se si do të jenë semaforët që do të vendosen, pastaj pozicionet nuk janë krejt të qarta për të gjithë OE. As kushtet e veçanta të kontratës nuk janë hartuar gjatë fazës së përgatitjes së dosjes së tenderit.

Validiteti i tenderit është kërkuar 60 ditë, përkundër që ligji kërkon që për kontrata të vlerës së madhe validiteti duhet të jetë 90 ditë. Po ashtu, edhe siguria e ekzekutimit të kontratës është kërkuar vetëm për 120 ditë, edhe pse kontrata e nënshkruar është tri (3) vjeçare.

Kontrata e nënshkruar me OE “INTRAST”, “Ekoinvest”, “Drini Company”, me çmim prej 174,982.20€, me kohëzgjatje tri (3) vjeçare, nuk është publikuar.

Gjetjet në aktivitetet e prokurimit në Podujevë

Në të dy tenderët e komunës së Podujevës janë gjetur shkelje të nenit 9 të LPP-së, i cili obligon komunën që të sigurohet se mjetet financiare për financimin e kontratave janë të mjaftueshme dhe të disponueshme, Gjetjet tregojnë se komuna ka lidhur kontrata në shuma më të larta se disponueshmëria e mjeteve në buxhetin e komunës. Po ashtu, mos vlerësimi i ofertave sipas ligjit ka rezultuar që në njërin tender të parashtrihen ankesa në OSHP dhe të stërgjatën procedurat për dhënien e kontratës.

Ndërtimi i bulevardit dhe sheshit 'Sheshi i Dëshmorëve në qendrën e qytetit

Njoftimi për kontratë për këtë tender është publikuar më 08.04.2019. INPO ka monitoruar këtë tender të vlerës së madhe dhe ka evidentuar disa shkelje. Më qëllim të parandalimit të parregullsive, INPO ka kontaktuar me zyrtarët e komunës, në mënyrë që të adresohen gjetjet. Mirëpo komuna nuk i ka adresuar ato.

Në bazë të analizës së dosjes së tenderit është gjetur se kërkesat minimale të kualifikimit sa i përket kapacitetit teknik dhe profesional, të vendosura në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosje të Tenderit siç janë: (i) Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku nga 30 (tridhjetë) punëtorë në listën e punëtorëve të paraqitur në ATK për secilin vit, në tri vitet e fundit nga publikimi i njoftimit për kontratë, (ii) Dëshmi nga ATK-ja për pagesën e kontributeve së paku tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, (iii), udhëheqës i punishtes - inxhinier i diplomuar ose master i ndërtimtarisë – pesë (5) vite përvojë pune pas diplomimit (drejtimi konstruktiv), si udhëheqës i punishtes në projektet e ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve dhe strukturave dhe (iv) udhëheqësi i punishtes duhet të ketë udhëhequr në tre (3) vitet e fundit (nga data e publikimit të njoftimit së paku dy kontrata në vlerën e parashikuar)⁵³, janë ndesh me nenin 69 të LPP-së dhe me RrOUP. Ligji përcakton se AK mund të kërkojë minimumin e mesatares së fuqisë punëtore dhe stafit menaxherial për secilin nga tri (3) vitet e fundit, ku si dëshmi mund të kërkojë një deklaratë apo raport për fuqinë mesatare punëtore dhe numrin mesatar të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik për secilin nga tri vitet e kaluara.

INPO ka gjetur mospërputhshmëri në mes të dokumenteve të planifikimit sa i përket vlerës së kontratës. Vlera e parashikuar në njoftimin për kontratë ishte 3,233,887.25€, ndërkaq sipas Planifikimit Përfundimtar të Prokurimit, vlera e parashikuar ishte 866,500.00€. Ndërsa sipas Ligjit për ndarjet buxhetore për vitin 2019, të planifikuara për këtë aktivitet të prokurimit në total ishin 1,196,500€ (866,500.00€ për vitin 2019 dhe

⁵³ Dosja e tenderit, e qasshme në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=327>

330,000.00€ për vitin 2020).⁵⁴ Rrjedhimisht, AK nuk kishte përmbushur kërkesat e nenit 9 të LPP-së, dhe mos përmbushja e këtyre kërkesave është shkelje e kësaj dispozite.

Në këtë tender kishin ofertuar 10 OE dhe të gjithë kanë qenë të përgjegjshëm sipas AK-së. Komuna më 18.06.2019 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK dhe ka shpallur fitues Grupin e OE “Alfa-I” dhe “Konstruktori ing 1969”, në vlerë të ofertës prej 2,269,321.95€, i cili ka qenë edhe oferta më e lirë.

Pas publikimit të këtij vendimi nga Komuna e Podujevës, ka pasur kërkesë për rishqyrtim me ç’rast lënda kthehet në ri-vlerësim. Pas ri-vlerësimit KK Podujevë më 02.08.2019 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK dhe ka shpallur fitues të njëjtin OE që e kishte rekomanduar edhe në herën e parë.

Edhe për këtë vendim të dytë me radhë ka pasur kërkesa për rishqyrtim dhe ankesë në OSHP nga OE, me pretendimet ankimore se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar kërkesat teknike dhe profesionale, me ç’rast OSHP ka nxjerrë vendim dhe ka anuluar njoftimin për dhënie të kontratës dhe lënda është kthyer në ri-vlerësim. Pas rivlerësimit Komuna e Podujevës më 04.09.2019 ka nxjerrë njoftimin mbi vendimin e AK, duke rekomanduar për kontratë grupin e OE-ve “ABC” dhe “Kosova Asfalt”, të tretët me radhë për nga çmimi i ofertës ndërkaq ka eliminuar tre (3) OE, me arsyetimin se ju mungojnë referencat, mjetet e punës dhe faturat për blerje të mjeteve, edhe pse në vlerësimin e parë të ofertave të gjithë kishin qenë të përgjegjshëm.

Në lidhje me këtë vendim të Komunës së Podujevës, janë paraqitur tri (3) kërkesa për rishqyrtim dhe lënda prapë është kthyer në rivlerësim. Më 26.09.2019, pas ri-vlerësimit Komuna e Podujevës ka nxjerrë vendimin e katërt (4) me radhë dhe ka shpallur fitues Grupin e OE “Alfa-I” dhe “Konstruktori ing 1969”. Po ashtu edhe pas këtij vendimi ka pasur kërkesa për rishqyrtim dhe ankesë në OSHP nga OE, me pretendimet ankimore se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar kërkesat teknike dhe profesionale dhe Siguria e tenderit nuk i përmban të gjitha kushtet që duhet të përmbaj polisa e sigurimit. Lidhur me këto ankesa OSHP më 13.11.2019 ka nxjerrë vendim dhe ka lënë në fuqi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës Grupin e OE “Alfa-I” dhe “Konstruktori ing 1969” në vlerë të ofertës prej 2,269,321.95€.

Pas gjithë kësaj game të stërzgatur të kësaj procedure që nga publikimi i saj më 08.04.2019, më në fund është bërë publikimi i njoftimit për dhënie të kontratës më 15.11.2019.

⁵⁴ Ligji për ndarje buxhetore, i qasshëm në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4CEFBA4C-4397-4901-AB93-2AA37F43A9F7.pdf>

Ndërtimi i objektit të ri të Emergjencës

Për këtë projekt komuna nuk i ka përmbushur kërkesat e nenit 9 të LPP-së. Nënshkrimi i kontratës është bërë më 20.08.2019 me OE “Intering Construction” & “Mel Engineering” në vlerë prej 519,688.87€, ndërkaq mjete të planifikuara për këtë projekt kishin qenë vetëm 288,621€.

Tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ndër të tjera ishin kërkuar mjetet e punës të domosdoshme për realizimin e punimeve në këtë projekt, mirëpo nuk ishte specifikuar se çfarë lloj mjetesh kërkohen. Kjo kërkesë është gjithëpërfshirëse dhe si e tillë nuk paraqet specifikisht se çfarë lloj mjetesh janë të domosdoshme për të dëshmuar se një OE i plotëson kërkesat minimale për realizimin e këtij projekti. Nëse, lihet në vullnet të OE-ve të zgjedhin se çfarë lloj mjetesh të ofrojnë në listën e pasiveje mund të ndodhë që disa nga këto pajisje të mos jenë fare të nevojshme për realizim të këtij projekti.

Gjithsej tetë (8) OE kishin ofertuar për këtë tender, ku shumica janë shpallur të pasuksesshëm për shkak se nuk kanë qenë tenderi më i lirë, ndërkaq një OE është eliminuar pasi nuk ka paraqitur listën e kontratave të kryera për punë të ngjashme. Nuk ka pasur ankesa nga OE.

Gjetjet në aktivitetet e prokurimit në Shtime

Në tenderët e monitoruar të komunës së Shtimes janë gjetur shkelje të ligjit sa i përket referimit të një prodhimi apo burimi specifik, ose markave apo llojeve të caktuara të produkteve. Gjithashtu, është gjetur se komuna ka kontraktuar artikuj të caktuar me çmim jo-normalisht të ulët.

Furnizim me Mirëmbajte të Ndërtesave për Institucionet e Komunës së Shtimes

Pas publikimit të njoftimit për kontratë, komuna kishte vendosur disa kërkesa sa i përket kërkesave mbi gjendjen ekonomike dhe financiare dhe atyre teknike dhe profesionale në kundërshtim me ligjin. Pas rekomandimeve të INPO-s, komuna ka bërë përmirësimin e gabimeve përmes publikimit të formularit standard.

Tutje, komuna nuk ka përcaktuar specifikimet teknike të detyrueshme në dosjen e tenderit. Kjo është bërë vetëm përmes Listës së Çmimeve, e cila nuk ka një specifikim të detajuar për secilin produkt.⁵⁵ INPO ka gjetur se në listën e çmimeve figurojnë specifikime të produkteve që i referohen një artikulli të veçantë dhe markave tregtare (slovene), në disa raste duke ju referuar “ose ekuivalente”, (shembull: Priza njëfazore të dyfishta nga prodhuesit LEGRAND, TICINO dhe GEWIS ose ekuivalent). Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, është *i ndaluar*. Përdorimin e cilësimit “ose ekuivalente” ligji e lejon vetëm në raste të jashtëzakonshme, kur autoriteti kontraktues nuk mund të përpilojë specifikim mjaftë të saktë. Në këtë tenderi kishte ofertuar vetëm një OE, me të cilin ishte lidhur kontrata.

Furnizim me pajisje tjera për institucionet e Komunës së Shtimes/Ri-Tenderim

Edhe në këtë tender komuna nuk ka përcaktuar specifikimet teknike të detyrueshme në dosjen e tenderit. Përshkrimi i produkteve është bërë vetëm përmes Listës së Çmimeve, e cila nuk ka një specifikim të detajuar për secilin produkt. Si pasojë shtatë (7) nga tetë (8) OE ofertues janë eliminuar për shkak se ofertat e tyre kanë tejkaluar vlerën e parashikuar për këtë aktivitet. Disa edhe për njëfishin e vlerës së saj, pasi në mungesë të specifikave të nevojshme për produkte kanë ofertuar me çmim më të shtrenjtë.

Shembulli për produktet pa specifikime: Aparat saldues, thithëse elektrike, blinder, grirëse, motor për kositjen e barit (me benzinë), tenxhere komplet 1x6, etj.⁵⁶ Po ashtu, në disa produkte janë përpiluar specifikime që i referohen një artikulli të veçantë dhe markave tregtare, si BEKO, PHILIPS, KALE, etj, në disa raste duke ju referuar me “ose ekuivalente”. Vlen të përmendet specifikimi që kishte bërë komuna për artikullin

⁵⁵ Dosja e tenderit dhe lista e çmimeve, e qasshme në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=327>

⁵⁶ Lista e çmimeve, e qasshme në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=327>

“Hekur Philips në super ofertë verore deri më 27 Gusht.”⁵⁷ NPO ka gjetur se ky produkt ka qenë i disponueshëm në kompaninë NEPTUN më 12.08.2019.⁵⁸ Tutje, pas nënshkrimit të kontratës, INPO ka gjetur se produktin TV Philips smart 55 inch komuna e ka kontraktuar me çmim për njësi prej 250€, përderisa në treg një TV më këto specifika, kushton më së paku 500€.⁵⁹ Për disa produkte tjera, kërkohet që gjatë furnizimeve për tipin dhe llojin e tyre duhet të merret aprovimi nga organi mbikëqyrës. Kontrata është lidhur me OE GRYKA, në vlerë prej 10,986.70€.

Gjetjet në aktivitetet e prokurimit në Zveçan

Në këtë komunë është gjetur se si rezultat i përdorimit të kriterëve diskriminuese nuk ka pasur OE të interesuar për ofertim. I vetmi OE ofertues është eliminuar për shkak të mos përmbushjes së këtyre kriterëve.

Projektit kryesor për ndërtimin e rezervuarëve të ujit të pijshëm në Zveçan

INPO ka gjetur se kërkesa minimale e kualifikimit e vendosur në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosje të Tenderit “Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se me sukses ka realizuar shërbime të njëjta ose të ngjashme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës së paku tri (3) me vlerë minimale të kontratës prej 58,000.00€”, është në kundërshtim me nenin 69 të LPP-së dhe kufizojnë konkurrencën e lirë dhe diskriminojnë OE-të.

Po ashtu, Kërkesa minimale e kualifikimit e vendosur në Dosjen e Tenderit “*Afati për dorëzimin e projektit kryesor jo më gjatë se 30 ditë kalendarike*” nuk është kërkesë e nenit 69 të LPP-së, dhe nenit 26 të RrUOPP. Përveç kësaj, kjo është në kundërshtim edhe me nenin 51 të LPP-së, paragrafi 1, i cili obligon AK-të, të mos përfshijnë, saktësojnë ose përdorin kriterë të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera, përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji. Tutje, kërkesa “*Vizitë e obligueshme në vendpunim me datë 24.05.2019. në ora 10:00. Takimi para komunës së Zveçanit. Personi kontaktues Nadica Hristov, dia*”. Kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 18. paragrafi 4 të RrUOPP, i cili sqaron se vizitat e tilla nuk duhet të jenë obligative.

INPO ka gjetur se përmbajtja e njoftimit për kontratë dhe dosja e tenderit nuk ishin identike. Validiteti i sigurimit të kontratës ishte vendosur në kundërshtim me ligjin. Sipas njoftimit për kontratë, siguria e ekzekutimit ishte kërkuar të jetë valide për 13 muaj, ndërsa në dosjen e tenderit ishte 24 muaj.

⁵⁷ Po aty.

⁵⁸ Oferta e NEPTUN, e qasshme në:

<https://www.facebook.com/NeptunKS/photos/a.343569205757933/1816722868442552/?type=3&theater>

⁵⁹ Shih linkun: <http://aztech-ks.com/electronics/kategorite/tv-video/tv/?srt=1&c2%5B%5D=55-inch&onSale=0>

Pas hapjes së ofertave dhe vlerësimit të tyre, më 11.06.2019 komuna ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit, ku kishte ofertuar vetëm një OE dhe i njëjti ishte eliminuar për shkak se nuk i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit.

Shërbimet e sigurisë fizike të objektit të ZKK

Komuna më 20.06.2019 ka filluar këtë aktivitet të prokurimit, kontratë publike kornizë me një OE në kohëzgjatje prej 36 muajsh. INPO ka gjetur se kishte mospërputhshmëri mes Deklaratës së Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve dhe dosjes së tenderit sa i përket vlerës së parashikuar të kontratës. Në Deklaratën e Nevojave dhe Njoftimin për Kontratë vlera e parashikuar e kontratës ishte 34 mijë euro, ndërkaq kohëzgjatja e kontratës nuk ishte përcaktuar fare, ndërkohë që validiteti i sigurimit të ekzekutimit të kontratës ishte kërkuar për 37 muaj.⁶⁰ Ndërkaq në dosjen e tenderit vlera e parashikuar e kontratës “34,000.00€/vit, përkatësisht 102,000€/3vite”.⁶¹ Ky planifikim i vlerës së kontratës është në kundërshtim me nenin 9 të LPP-së. Po ashtu, mos saktësimi i vlerës së kontratës në njoftimin për kontratë ka mundur të ndikojë edhe në mosinteresimin e OE për të ofertuar.

Për këtë tender kishte ofertuar OE “PANTHER”, i cili e kishte fituar kontratën, me vlerë indikative të çmimit prej 100,871.40€.

⁶⁰ Njoftimi për kontratë, i qasshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=513540

⁶¹ Dosja e tenderit e qasshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=513540

Kontraktimi i shërbimeve nga OJQ-të përmes prokurimit publik

Ligji për Prokurimin Publik në fuqi i njeh OJQ-të si operatorë ekonomik, mirëpo nenin 132/A të këtij ligji, përcaktohet se Qeveria e Republikës së Kosovës me akt nënligjor përcakton rregullat, standardet dhe procedurat e kontraktimit të shërbimeve publike për organizatat e shoqërisë civile.

Në Kosovë nuk ka legjislacion adekuat, i cili rregullon standardet dhe procedurat për kontraktimin e OJQ-ve për ofrimin e shërbimeve publike nga ana e komunave, ministrive, apo agjencive të pavarura. Në vitin 2017, Ministria e Financave ka miratuar rregulloren MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet, dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve. Mirëpo, kjo rregullore nuk e rregullon çështjen e kontraktimit të shërbimeve që ofrohen nga OJQ-të.

Qeveria e Republikës së Kosovës deri më tash nuk ka nxjerrë ndonjë akt nënligjor, i cili rregullon këtë fushë, ndërkohë që disa komuna tanimë kanë lidhur kontrata për shërbime me OJQ në vlera të majme monetare, përmes instrumentit të prokurimit publik.

Në kuadër të monitorimit të prokurimit publik në komuna, INPO ka hasur në katër (4) aktivitete të prokurimit që kanë rezultuar me lidhjen e kontratave publike për shërbime me OJQ, të cilat kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Në asnjërën nga këto aktivitete të prokurimit nuk është shënuar se kontraktimi i shërbimeve është planifikuar të bëhet nga OJQ-të.

Konkretisht, INPO ka monitoruar këto kontrata: (i) *“Shërbime për realizimin e vitalizimin e infrastrukturës për funksionalizimin e projektit shtetërit shtëpiakë”* në komunën e **Suharekës** me vlerë prej **219,725.50€** në kohëzgjatje prej 12 muajsh; (ii) *“Kujdesi Socio-Shëndetësor shtëpiak dhe ambulantor për qytetarët e komunës së Prizrenit”* në **Prizren** me vlerë prej **219,725.50€** në kohëzgjatje prej 12 muajsh; (iii) *“Shërbime Profesionale për QKMF dhe Administratën Komunale”* në **Gjilan** me vlerë prej **539,600€** në kohëzgjatje prej 36 muajsh; si dhe në komunën e **Shtimes** (iv) *“Kujdesi shtëpiak palativ i të sëmurëve”*, për të cilën INPO nuk të dhëna për vlerën reale të kontratës dhe kohëzgjatjen e saj.

INPO ka gjetur se për këto kontrata kishte vetëm një (1) ofertues, një OJQ, e cila edhe i ka fituar të gjitha këto kontrata. Nga hulumtimi i këtyre kontratave, rezulton se në dosjet e tenderit të tri (3) kontratave,⁶² specifikimet teknike të detyrueshme janë identike me njëra tjetrën dhe vetëm sasia është e ndryshme. Në mes tjerash, në të tri (3) dosjet, rezulton se specifikimet kanë këtë përmbajtje:

⁶² Kontratat e lidhura nga komunat: Prizren, Suharekë dhe Shtime.

1. Shërbimet e kujdesit shëndetësor shtëpiak dhe ambulantor të ofruara nga mjekë të përgjithshëm, si vizitë mjekësore, marrja e anamnezës, shikimi i dokumentacionit mjekësor ekzistues të pacientit, ekzaminimi i pacientit, matja e tensionit arterial dhe parametrave të tjerë vital, përcaktimi i diagnozës, vendosja e menaxhimit të terapisë, edukimi shëndetësor, vendosja e planit të mjekimit, përcjellja e gjendjes shëndetësore të pacientit dhe sipas nevojës udhëzimi për kujdes në nivelin dytësor dhe tretësor.
2. Shërbimet infermiere të kujdesit shëndetësor shtëpiak do të përfshijnë: Përgatitja e pacientit për vizitë mjekësore, matja e shenjave vitale, aplikimi i terapisë orale dhe parenterale, pastrimi dhe lidhja e plagëve, vendosja dhe ndërrimi i kateterëve urinar, oksigjenoterapia, edukimi shëndetësor, ushtrimet pasive dhe aktive si preventive për dekubite, dokumentimi, etj.
3. Marrja e gjakut për analiza, ruajtja dhe transporti deri në laborator, përpunimi i tyre dhe dorëzimi i rezultateve, për personat në gjendje të rëndë sipas kërkesës dhe udhëzimit të mjekut.

Përfshirja në këto komuna e Gjilanit, e cila specifikimet teknike i ka në formë tjetër, por që poashtu kanë të bëjnë me shërbimet e kujdesit shëndetësor të ofruara nga mjeku i përgjithshëm, infermierët dhe stomatologët.

Tek kërkesat e përshtatshmërisë profesionale në dosjet e tenderit, INPO gjen se Komuna e Gjilanit dhe Suharekës nuk kishte kërkuar fare licencën e OJQ-së, që dëshmon se është i licencuar për ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Ndërkaq, Komuna e Prizrenit ka kërkuar që OJQ-ja të jetë i licencuar për ofrimin e shërbimeve socio-shëndetësore dhe ambulatore të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në nivel nacional.⁶³

INPO ka gjetur se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, nuk ka kompetencë ligjore që të licencojë OJQ-të në fushën e shëndetësisë apo shërbimeve ambulatore. Kjo ministri licencon OJQ-të në fushën e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare, siç janë të përshkruara në Ligjin për Shërbime Sociale.⁶⁴ Ky ligj nuk e trajton ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe ambulatore. Sipas Ligjit për Shëndetësinë, është Ministria e Shëndetësisë ajo që e bën licencimin e institucioneve humanitare dhe shërbimeve shëndetësore që ofrohen nga shoqëria civile.⁶⁵

⁶³ Dosja e tenderit, Komuna e Gjilanit, e qasshme në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=327>

⁶⁴ Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-081

⁶⁵ Shënim: Neni 38 i Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësinë, përcakton se shërbimet e kujdesit shëndetësor në institucionet shëndetësore humanitare dhe në format e tjera të organizimit të shoqërisë civile në lëmin e shëndetësisë, rregullohen me akt nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria. Në vitin 2014, Ministria e Shëndetësisë ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ (MSH)04/2014 për shërbimet e kujdesit shëndetësor

Zyra për Qeverisje të Mirë, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, ka deklaruar për INPO-n se *“Licencat janë një parakusht për të aplikuar për ofrimin e shërbimeve përkatëse dhe kjo vlen edhe për ofruesit e tjerë të shërbimeve, përveç ofruesve të shërbimeve shtetërore.”*⁶⁶

Të gjeturat tregojnë se OJQ “Caritas Kosova”, fituese e këtyre kontratave është e licensuar vetëm në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, respektivisht “Ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për persona të moshuar, persona me aftësi të kufizuara dhe fëmijë të marginalizuar në nivel nacional. Nr. i licencës 30/2018.”⁶⁷

Tutje, Komuna e Prizrenit dhe Suharekës, nuk kishte kërkuar listën e punonjësve shëndetësorë dhe nuk kishin kërkuar dëshmi se punonjësit shëndetësorë janë të licensuar në ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Përjashtim bën, Komuna e Gjilanit, e cila përmes dosjes së tenderit kishte kërkuar pesë (5) mjekë të përgjithshëm, dy (2) stomatologë, pesëmbëdhjetë (15) infermierë, dy (2) teknik të dhëmbëve, etj., të gjithë të lincensuar.

INPO përmes kërkesës për qasje në dokumente publike, ka kërkuar nga Komuna e Gjilanit, qasje në ofertën e OJQ-së fituese, mirëpo komuna ka ofruar vetëm qasje të pjesshme, me çka lë hapësirë të ngritën dyshime se OJQ-ja nuk kishte ofruar dëshmitë për punëtorët shëndetësorë të kërkuar në dosjen e tenderit. INPO-s i janë ofruar vetëm tri (3) kontrata të teknikëve të farmacisë, si pjesë përbërëse e ofertës së OJQ-së. Një (1) nga tre teknikët e farmacisë rezulton të jetë i punësuar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Fushë Kosovës.⁶⁸ Dokumentet e tjera që dëshmojnë se OJQ-ja ka përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit për stafin mjekësor, nuk janë ofruar për INPO-n.

INPO vlerëson së komunat respektive gjatë udhëheqjes së procedurave për të kontraktuar shërbime mjekësore dhe ambulantore nga OJQ-të kanë vepruar në kundërshtim me bazën ligjore. Në bazë të hulumtimit, INPO ngritë dyshime se këto kontrata janë shfrytëzuar për të punësuar staf shëndetësorë në Qendrat e Mjekësisë Familjare të Komunave.

INPO shpreh shqetësim në lidhje me kontraktimin e këtyre shërbimeve nga OJQ-ja, e cila nuk ka ofruar dëshmi se i ka plotësuar të gjitha kriteret ligjore, duke përfshirë licencën për ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe dëshmitë e tjera të stafit

në Institucionet Shëndetësore dhe Humanitare dhe format e tjera të organizimit të shoqërisë civile në lëminë shëndetësore.

⁶⁶ Përgjigje përmes postës elektronike, znj. Trëndelina Dreshaj, Zyrtare e Lartë për Qeverisje të Mirë, Zyra për Qeverisje të Mirë

⁶⁷ Lista e OJQ-ve, të licensuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, e siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike.

⁶⁸ Shënim: INPO ka hulumtuar CV-të e kandidatëve me të cilët ka ofertuar OJQ-ja.

mjekësorë. Prandaj, INPO ngritë dyshime se këto kontrata janë lidhur me qëllim të punësimit të stafit shëndetësorë në Qendrat e Mjekësisë Familjare të këtyre komunave.

Për më tepër, ofrimi i shërbimeve mjekësore në asnjë formë nuk mund të ofrohet nga personat apo organizatat që nuk posedojnë dokumentet valide, të cilat kërkohen me legjislacionin pozitiv. Nga kjo, INPO vlerëson se mund të rezultojë në ofrimin e shërbimeve jo adekuate, të cilat mund të dëmtojnë interesat e qytetarëve, rrjedhimisht mund të dëmtohet interesi publik i komunës, duke shpenzuar buxhetin në kundërshtim me qëllimin e saj.

Gjetjet kryesore në menaxhimin e zbatimit të kontratave

Gjatë monitorimit të kontratave publike në 38 Komunitet e Republikës së Kosovës, INPO ka gjetur se disa prej komunave kanë shkelur dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik. INPO në vazhdim i ka grupuar si çështje shkeljet më problematike të identifikuara gjatë monitorimit të aktiviteteve të prokurimit publik.

Shkeljet ligjore lidhur me planin e menaxhimit të kontratave

INPO gjatë monitorimit dhe analizimit të zbatimit të kontratave ka gjetur shkelje të shumta ligjore lidhur me hartimin e planeve për menaxhimin e kontratave (PMK-ve). Në këtë drejtim, INPO ka identifikuar në dhjetë komuna, 14 kontrata të tilla publike.

Në kontratën *“Ndërtimi i rreth rrotullimit të rrasat dhe rija në Rahovec”*, **1) Komuna e Rahovecit** ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e RrOUP-së pasi që ka filluar implementim e kontratës pa e plotësuar PMK-në përputhje me afatet ligjore dhe në pajtim me palët kontraktuese, respektivisht AK-së dhe OE-së.

Shkelje të ngjashme janë identifikuar edhe në kontratat publike të komunave: **2) Mitrovicë** – 2.1) *“Renovimi i objektit të SHFMU Musa Hoti në Mitrovicë”* dhe 2.2) *“Ndërtimi i Ujësjellësit dhe kanalizimit fekal në qytet”*; **3) Lipjan** – 3.1) *“Ndërtimi i Shkollës fillore në fshatin Rubovc, faza II”* dhe 3.2) *“Ndërtimi i shkollës fillore SHFMU “Naze Bujani”, Bujan paralele e ndarë Bregu i Zi*; **4) Hani Elezit** – 4.1) *“Rregullimi i shtratit të prroit të Dimcës” LOT 1 dhe LOT 2*; **5) Klinë** – 5.1) *“LOT 2 Ndërtimi i kanaleve për ujitje në Rudice”*; **6) Ranillugë** – 6.1) *“Rekonstruimi i ndriçimit publik në Komunën e Ranillugut”* dhe 6.2) *“Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Ranillugut”*; **7) Prizren** – 7.1) *“Renovimi i sallës së edukatës fizike në Gjimnazin Gjon Buzuku në Prizren”* dhe 7.2) *“Furnizim me një automjet special për shërbimin e zjarrfikëseve në Komunën e Prizrenit”*; **8) Shtërpçë** – 8.1) *“Rindërtimi i shkollave fillore dhe të mesme në territorin e Komunës së Shtërpçës”*; **9) Junik** – 9.1.) *“Ndërtimi i kanaleve të ujitjes”*; **10) Kamenicë** – 10.1) *“LOT I Furnizim me material Laboratorik dhe reagensa”*.

Shkeljet ligjore lidhur me sigurimin e ekzekutimit të kontratave publike

INPO gjatë monitorimit dhe analizimit të zbatimit të kontratave ka gjetur shkelje të shumta ligjore lidhur me validitetin e sigurimit të ekzekutimit të kontratave publike. Sipas ligjit, siguri për ekzekutimin e kontratave duhet të jetë valid në kohëzgjatje prej 30 ditëve pas përfundimit të kontratës. Kjo masë siguron autoritetin kontraktues që në rast të moszbatimit efikas të kontratës t’ia konfiskojë operatorit ekonomik shumën e siguruar në 10% të vlerës së kontratës. Në këtë drejtim, INPO ka identifikuar në shtatë (7) komuna, tetë (8) kontrata të tilla publike.

1) Komuna e Mitrovicës në kontratën publike *“Renovimi i objektit të SHFMU Musa Hoti në Mitrovicë”* nuk e ka kërkuar sigurimin e ekzekutimit të kontratës në përputhje me kërkesat e LPP-së, pasi që kohëzgjatja e kontratës është për nëntë (9) muaj, ndërsa sigurimi i ekzekutimit kërkohej që të jetë për 12 muaj.

Shkelje të ngjashme janë identifikuar edhe në kontratat publike të komunave: **2) Lipjan** – 2.1) *“Ndërtimi i Shkollës fillore në fshatin Rubovc, faza II”*; **3) Zveçan** – 3.1) *“Prokurimi i mjekësore për nevojat e Qendrës Shëndetësore “Zveçan”*; **4) Istog** – 4.1) *“Ndërtimi i ambulancës në fshati Zallq”*; **5) Kaçanik** – 5.1) *“Ndërtimi i objektit për banim social”* dhe 5.2) *“Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Kovaçec”*; **6) Junik** – 6.1) *“Ndërtimi i kanaleve të ujitjes”* si dhe **7) Deçan** 7.1) *“Ujësjetillësi për dhjetë fshatrat dhe kyçja në burime të reja-2”*.

Shkeljet ligjore lidhur me caktimin e afatit për zbatimin e kontratave

INPO gjatë monitorimit dhe analizimit të zbatimit të kontratave ka gjetur shkelje të shumta ligjore lidhur me caktimin e afatit të fillimit dhe mbarimit të zbatimit të kontratave publike. Sipas nenit 20 të RrOUP kërkohej që AK-të saktësisht të caktojnë datën e fillimit dhe implementimin të projektit/kontratës. Në këtë drejtim, INPO ka identifikuar në 10 komuna, 16 kontrata të tilla publike.

1) Komuna e Vitisë në dy (2) të kontrata publike, përkatësisht në kontratat *“Rregullimi i kulmit të gjimnazit “Kuvendi i Lezhës”* dhe *“Furnizimi me aparaturë medicinale për nevojat e QKMF-së”* nuk e saktësuar datën e fillimit dhe përfundimit të punimeve. Rrjedhimisht, është vepruar në kundërshtim me rregullat dhe udhëzuesin për prokurim publik, i cili përcakton se në kontratat publike duhet të theksohet data e fillimit dhe përfundimit të punimeve. Komuna e Vitisë në këto dy kontrata ka vepruar në kundërshtim me ligjin, duke mos-saktësuar datat e fillimit dhe përfundimit të punimeve por në vend të saj, në kontrata ka cekur numrin e ditëve të punës për këto dy projekte përkatëse. Për më tepër kontrata *“Rregullimi i kulmit të gjimnazit “Kuvendi i Lezhës”* është lidhur më 30.06.2017, me kohëzgjatje prej 90 ditë pune, ndërsa *“Furnizimi me aparaturë medicinale për nevojat e QKMF-së”*, është nënshkruar më 03.12.2018, me kohëzgjatje pesë (5) ditë nga marrja e Urdhërësës për liferim.

Shkelje të ngjashme janë identifikuar edhe në kontratat publike të komunave: **2) Klinë** – 2.1) *“LOT 1 Ndërtimi i kanaleve për ujitje në Kpuz”* dhe 2.2) *“LOT 2 Ndërtimi i kanaleve për ujitje në Rudice”*; **3) Ranillugë** – 3.1) *“Rekonstruimi i ndriçimit publik në komunën e Ranillugut”*; **4) Novobërde** – 4.1) *“Rregullimi (ndërtimi) i stadiumit për futboll të vogël në fshati Prekoc”* dhe 4.2) *“Ndërtimi i tre rezervarëve të ujit për ujësjetillës në fshatrat të KK Novobërde”*; **5) Gjakovë** – 5.1) *“Ndërtimi- Asfaltimi i rrugës në fshatin Brekoc, lagja Muqaj- Kontratë dy vjeçare”* dhe 5.2) *“Ndërtimi i objektit të Qendrës Kryesore Familjare në Gjakovë”*; **6) Graçanicë** – 6.1) *“Furnizim me mjete pune, pajisje tjera për nevojat e*

Komunës” dhe 6.2) “Ndërtimi i çerdhes se fëmijëve në Uglar”; 7) Prizren – 7.1) “Renovimi i sallës së edukatës fizike në Gjimnazin Gjon Buzuku në Prizren”; 8) Vushtrri – 8.1) “Ndërtimi i fushës sportive dhe rrethojave metalike të fushave sportive në shkolla”; 9) Prishtinë – 9.1) “Revitalizimi i shkallëve dhe ndërtimi i mbikalimit në lagjen Arbëria” dhe 9.2) “Ndërtimi i sallës së edukatës fizike të shkollës “Avni Rustemi” Mramor”; 10) Kaçanik – 10.1) “Ndërtimi i objektit për banim social” dhe 10.2) “Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Kovaçec”.

Pasojat e shkeljeve ligjore rreth lidhjes së kontratave për të cilat komunat nuk kanë pasur buxhet

INPO gjatë monitorimit dhe analizimit të zbatimit të kontratave ka gjetur shkelje të shumta ligjore lidhur me kontratat publike, të cilat janë lidhur nga Komunat, pa e pasur buxhetin e siguruar, rrjedhimisht duke krijuar borxhe publike të Komunës ndaj kompanive të caktuara. Sipas interpretimit Nr.133/2017 të KRPP-së, iniciimi apo ekzekutimi i cilit do aktivitet të prokurimit pa siguruar fonde të mjaftueshme dhe sipas ligjit është kundërligjore dhe përgjegjësia mbetet mbi zyrtarët e AK-ve të cilët kanë ndërmarrë veprime të tilla kundërligjore. Në këtë drejtim, INPO ka identifikuar në shtatë (7) komuna, shtatë (7) kontrata të tilla publike.

1) Komuna e Prizrenit kontratën publike *“Renovimi i sallës së edukatës fizike në Gjimnazin Gjon Buzuku në Prizren”* e kishte lidhur në vlerën 249,441.00€. Ndërkaq, në bazë të DNPDF-je, INPO ka gjetur se për këtë projekt kanë qenë të ndara vetëm 40,000€ dhe si i rezultat i mungesës së mjeteve financiare ky projekt ende nuk ka përfunduar.

2) Njëjtë është vepruar edhe nga Komuna e Klinës në kontratën publike *“LOT 2 - Ndërtimi i kanaleve për ujitje në Rudice”*. Vlera e parashikuar e këtij aktiviteti të prokurimit është 23,000.00€. Bazuar në Ligjin për Ndarjet Buxhetore për vitin 2018, për këtë projekt kanë qenë të planifikuara vetëm 10,000.00€, ndërsa për vitin 2019 nuk ka mjete të planifikuara.

Ngjashëm në kundërshtim me ligjin kanë vepruar edhe komunat tjera si: **3) Lipjan – 3.1)** *“Ndërtimi i Shkollës fillore në fshatin Rubovc, faza II”*; **4) Viti – 4.1)** *“Furnizimi me aparaturë medicinale për nevojat e QKMF-së*; **5) Rahovec – 5.1)** *“Ndërtimi i Sallës Sportive për SHML “Ukshin Hoti” në Krushë të Madhe”*; **6) Gjakovë – 6.1)** *“Ndërtimi-Asfaltimi i rrugës në fshati Brekoc, lagja Muqaj- Kontratë dy vjeçare”*; **7) Kaçanik –** *“Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Kovaçec”.*

Monitorimi i proceseve gjyqësore ndaj zyrtarëve të akuzuar për korrupsion në lidhje me prokurimin publik

INPO dhe IKD kanë monitoruar sistematikisht rastet gjyqësore, në të cilat janë të akuzuar zyrtarët e prokurimit publik. Gjatë këtij viti, janë monitoruar 23 seanca gjyqësore, ku përfshihen nëntë (9) lëndë në të cilat akuzohen për korrupsion zyrtarët e prokurimit publik të nivelit të institucioneve lokale dhe qendrore.

Karakteristikë e këtyre rasteve është se gjatë këtij viti, gjykatësit kanë shpallur aktgjykime liruese në pesë (5) raste, ndërsa në katër (4) rastet e tjera po vazhdojnë shqyrtimet gjyqësore.

Gjykimet në proces për korrupsion në prokurim publik të zyrtarëve komunal

Në nivelin komunal në lidhje me kryerjen e veprave penale në fushën e prokurimit publik janë akuzuar Drejtori i Zyrës së Prokurimit në Gjiçan, Lipjan dhe Prizren si dhe Kryetari i Komunës së Istogut, Haki Rugova.

- Kryetari i Komunës së Istogut, Haki Rugova, akuzohet se ia ka dhënë tenderin vëllait të tij, duke ia mundësuar kontratën përmes procedurave të prokurimit publik, kontratë kjo, të cilën e kishte nënshkruar personalisht. Sipas aktakuzës⁶⁹ së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, të ngritur më 26 mars të vitit 2018, Haki Rugova akuzohet se duke vepruar si kryetar i Komunës së Istogut, më 1 gusht 2014, ka nënshkruar kontratë me kompaninë “Ma-Con” sh.p.k. për ndërtimin e kanalizimit për fshatrat Cercë dhe Lubozhdë. Sipas aktakuzës, në momentin e lidhjes së kontratës për kryerjen e punëve ndërtimore në mes Komunës së Istogut dhe kompanisë “Ma-Con” sh.p.k. drejtor i firmës ka qenë Gani Rugova dhe çmimi i kontratës ka qenë 289,119.85 euro. Organi i akuzës pretendon se me anë të këtyre veprimeve, i akuzuari Rugova, i ka mundësuar vëllait të tij, Gani Rugovës, interes financiar, andaj e akuzon se ka kryer veprën penale të konfliktit të interesit. Fillimisht kjo lëndë ishte dërguar në Prokurorinë Themelore në Pejë, përkatësisht ajo i ishte deleguar prokurorit Haxhi Sinanaj. Por, ky i fundit, më 17 janar 2018, me shkresë i ishte drejtuar kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Ali Selimaj, dhe pas konsultimit me kryeprokurorin e Prokurorisë së Apelit, Haxhi Dërguti, si dhe Agim Kurmehaj, lënda është deleguar në Prokurorinë Themelore në Gjakovë. Arsyeja e dërgimit në kompetencë të kësaj çështjeje juridike penale për të pandehurin Haki Rugova, është fakti se me të njëjtin që një kohë të gjatë njihemi dhe jemi në raporte shoqërore, andaj për të qenë një hetim

⁶⁹ “Mbrotjtja dhe zyrtarja e prokurimit në Istog e quajnë aksidentale nënshkrimin e kontratës nga Haki Rugova për dhënien e tenderit vëllait të tij”. “Betimi për Drejtësi”. Publikuar më 23 tetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mbrotjtja-dhe-zyrtarja-e-prokurimit-ne-istog-e-quajne-aksidentale-nenshkrimin-e-kontrates-nga-haki-rugova-per-dhenien-e-tenderit-vellait-te-tij/>).

i drejtë dhe i pavarur, pas konsultimit me kryeprokurorin e Apelit dhe kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, jemi dakorduar që këtë çështje penale ta dërgojmë në kompetencë të Prokurorisë Themelore në Gjakovë”, kishte shkruar prokurori Haxhi Sinanaj. Ndryshe, Haki Rugova, në zgjedhjet lokale të vitit 2017, kishte fituar edhe një mandat tjetër, për herë të tretë, në krye të Komunës së Istogut. Ky proces gjyqësor është duke vazhduar ende.

- Drejtori i Zyrës së Prokurimit në Lipjan, Adem Duriqi, akuzohet për veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” sipas aktakuzës së ngritur më 28 prill 2017 nga Prokuroria Themelore në Prishtinë. Sipas aktakuzës,⁷⁰ Vishesella më 5 dhjetor 2014, në cilësinë e shefit të zyrës së planifikimit në Drejtorinë e Urbanizmit në Komunën e Lipjanit, duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar kishte vepruar në kundërshtim me kushtet e kontratës së lidhur mes Komunës së Lipjanit dhe operatorit ekonomik “Stublla”, me titull “Ndërtim i shkollës në fshatin Banullë”. Vishesella, si menaxher për kontratën, me qëllim të përfitimit për operatorin ekonomik “Stublla”, kishte nënshkruar situacione të papërfunduara, ku si pasojë e kësaj, nga MASHT-i ishin bërë pagesat këtij operatori për punë të cilat nuk i kishte realizuar, duke i shkaktuar dem buxhetit të Kosovës, në vlerë prej 44,436.85 euro. Po ashtu, të njëjtën gjë sipas prokurorisë, Vishesella e kishte bërë edhe me operatorin ekonomik “Te Muhameti”, duke i shkaktuar dëm buxhetit të shtetit në shumë prej 24,902.37 euro. Ky proces gjyqësor është duke vazhduar ende.
- Drejtori i Zyrës së Prokurimit në Gjilan, Salih Kçiku, akuzohet për veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” sipas aktakuzës së ngritur më 26 janar 2018 nga Prokuroria Themelore në Gjilan. Sipas aktakuzës,⁷¹ gjatë vitit 2014 në Gjilan, i akuzuari në cilësi të personit zyrtar, drejtor i Drejtorisë së Prokurimit në Komunën e Gjilanit, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, ka tejkaluar kompetencat e tij. Aktakuza thotë se ai kompetencat i ka kaluar me qëllim të përfitimit të çfarëdo dobie për vete ose për persona tjerë, duke punësuar dy familjarë të tij, në atë mënyrë që ka vendosur një OJQ “Psikoterapeutët në Veprim” në zyrën e arkivit të Drejtorisë së Prokurimit, e cila gjendet tek Qendra e Inkubatorit të Biznesit në Gjilan. Sipas aktakuzës, në këtë zyrë kanë qenë të vendosura dosje të tenderëve, e ndër të tjerash edhe dosja e

⁷⁰ “Drejtori i Prokurimit në Lipjan thotë se nuk i kujtohet të ketë thënë se ish-zyrtari i kësaj komune kishte kryer pagesa për punë të përfunduara”. “Betimi për Drejtësi”. Publikuar më 29 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/drejtori-i-prokurimit-ne-lipjan-thote-se-nuk-i-kujtohet-te-kete-thene-se-ish-zyrtari-i-kesaj-komune-kishte-kryer-pagesa-per-pune-te-parealizuar/>).

⁷¹ “Ish-shefi i prokurimit në Gjilan mohon fajësinë për asgjësim apo fshehje të materialit arkivor”. “Betimi për Drejtësi”. Publikuar më 12 nëntor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-shefi-i-prokurimit-ne-gjilan-mohon-fajesine-per-asgjesim-apo-fshehje-te-materialit-arkivor/>).

tenderit me dy raportet e vlerësimit të aseteve fikse dhe detyrimeve qarkulluese të KRM “Higjiena” në Gjilan, e të cilat zyrtarët policorë nuk kanë mundur t’i gjejnë, e ku rezultojnë të asgjësuar, e ku në të njëjtën OJQ, i pandehuri ka punësuar vajzën Antigona Kçiku dhe mbesën Naime Bunjaku. Ky proces gjyqësor është duke vazhduar ende.

- Shefi i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Prizrenit, Isa Osmankaj, akuzohet për veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, sipas aktakuzës së ngritur më 19 prill 2019 nga Prokuroria Themelore Prizren. Sipas aktakuzës,⁷² Osmankaj akuzohet se në periudhën kohore maj 2017, e deri në maj 2018, në cilësinë e shefit të zyrës së prokurimit në Komunën e Prizrenit, duke shfrytëzuar detyrën zyrtare apo autoritetin zyrtar, nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim të përfitimit të dobisë për tjetrin. Në aktakuzë thuhet se i akuzuari vepron në kundërshtim me Ligjin mbi Prokurimin Publik, lidhur me tenderin “Shenjëzimi horizontal, vertikal dhe vendosja e barrierave në rrugët e Prizrenit”, e lidhur me ankesën e operatorit ekonomik NPTSH “Limit L&B”, me seli në Prizren, si tenderues i suksesshëm, refuzon ankesën duke pretenduar se “Deklarata nën betim” e parashtruesit “Boja SHPK” me seli në Sambor dhe marrëveshja me të njëjtin partner është e falsifikuar, kërkon nga PSHP që të bëjë diskualifikimin e këtij operatori, për shkak të dokumenteve të falsifikuara të ndërmerren masa për falsifikim sipas nenit 92 të LPP-së, me ç’rast PSHP, me vendim me nr.259 të 4 majit 2017, refuzon ankesën me arsyetim se nuk kanë gjetur prova për falsifikim. Sipas aktakuzës, thuhet se i akuzuari më 19 qershor 2017, bënë njoftimin për dhënien e kontratës për operatorin ekonomik “Sinjalizimi” edhe pse ishte shpallur i papërgjegjshëm nga PSHP-ja, me këtë vendim nuk njofton operatorët e tjerë me qëllim që t’i shmang ankesat e operatorëve jo fitues, nuk njofton për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së ofertës dhe dorëzimin e garancisë së re, pa skaduar afati i ankesave. Në aktakuzë thuhet se ai e nënshkruan kontratën me operatorin “Sinjalizimi”, më 3 korrik 2017, duke vepruar në kundërshtim me paragrafin 4.1 dhe 4.3 të nenit 20 të ligjit 4/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, 05/L-068 dhe 05/L-042 për të cilat shkelje gjobitet nga OSHP-ja, edhe për kundër faktit se ky operator është shpallur i papërgjegjshëm më 10 gusht 2017, përsëri e shpall fitues operatorin “Sinjalizimi”, me ankesën e të dëmtuarit me 21 shtator 2017, ky njoftim është anuluar dhe përsëri pas rivlerësimit për kontratë, i pandehuri rekomandon operatorin e njëjtë. Gjithnjë sipas aktakuzës, thuhet se pas ankesës së operatorit ekonomik “LIMITI&BOJA&DRINI”, OSHP-ja më 19 tetor

⁷² “Shefi i zyrës së prokurimit në Prizren kundërshton aktakuzën, prokuroria thotë se ka prova të mjaftueshme”. “Betimi për Drejtësi”. Publikuar më 30 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shefi-i-zyres-se-prokurimit-ne-prizren-kundershton-aktakuzen-prokuroria-thote-se-ka-prova-te-mjaftueshme/>).

2017, kërkon që të anulohet i gjithë aktiviteti i prokurimit, me ç'rast më 5 dhjetor 2017, i pandehuri e anulon njoftimin për dhënien e kontratës dhe njofton OSSH-në, ndërsa duke mos respektuar dispozitat ligjore të LPP-së lejon që Komuna e Prizrenit, në maj të vitit 2018, të fillojë zbatimin e kontratës së anuluar nga OSHP-ja. Me këto veprime, ai akuzohet se ka shkelur të drejtat e operatorit ekonomik "LIMIT L&B" dhe i ka shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale, si dhe i ka mundësuar kompanisë "Sinjalizimi&Zmas" zbatimin e një kontrate jo ekzistente, në vlerë 358,039.06 euro, nga e cila kontratë deri me datën e kryerjes së ekspertizës janë realizuar punë në vlerë prej 163,257.72 euro. Me këtë, ai akuzohet se ka kryer veprën penale "keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar", nga neni 422, paragrafi 1, lidhur me paragrafin 2.1 të KPRK-së. Ky proces gjyqësor është duke vazhduar ende.

Aktgjykimet liruese për korrupsion ndaj zyrtarëve të prokurimit publik

Në pesë (5) proceset tjera gjyqësore ndaj zyrtarëve të lidhur me prokurimin publik, gjykatat kanë shpallur aktgjykime liruese. Gjykatat kanë liruar: ish-Kryetarin e Organit Shqyrtues të Prokurimit, Hysni Hoxhën, i akuzuar për veprën penale "keqpërdorim të pozitës zyrtare", ish-menaxherin e Zyrës së Prokurimit në Spitalin "Sheik Zayed", në Vushtrri, Mujë Ferati, i akuzuar për "keqpërdorim të pozitës zyrtare", ish-Udhëheqësen e Zyrës së Prokurimit në Spitalin Rajonal "Dr. Sami Haxhibeqiri" në Mitrovicë, Zylfije Halili e akuzuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare, ish-zyrtari i Prokurimit në kuadër të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Shaip Gashi, i akuzuar për veprën penale "shpërdorim i pozitës apo autorizimit" si dhe ish-zyrtarin e Prokurimit në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave (KRM) "Pastërtia" në Ferizaj, Ilir Beqiri.

- Ish-Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit, Hysni Hoxha, është akuzuar edhe në raste të tjera për korrupsion si Kryetar i OSHP-së por përfundimisht ishte liruar nga gjykata. Së fundi ai është liruar edhe në rastin e fundit, ku akuzohej për tenderin milionësh të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) për sigurimin fizik të objekteve të kësaj korporate, ku përfshiheshin edhe ish-kryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku, drejtori i KEK-ut, Arben Gjukaj dhe pesë të akuzuar të tjerë. Sipas aktakuzës,⁷³ në këtë proces gjyqësor, Sami Lushtaku është i ngarkuar me veprën penale "shtytje për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit", Arben Gjukaj e Hysni Hoxha, akuzohen për "keqpërdorim i pozitës zyrtare ose të autorizimit", Esat Tahiri dhe Milazim Lushtaku në bashkëkryerje akuzohen për "mashttrim" dhe "falsifikimit të dokumenteve", Driton Pruthi për veprat penale "keqpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit" dhe "lidhje e kontratës së

⁷³ "Sami Lushtaku dhe të tjerët lirohen nga akuzat në rastin e njohur KEK2". "Betimi për Drejtësi". Publikuar më 20 maj 2019. (Shih linkun https://betimiperdrejtesi.com/sami-lushtaku-dhe-te-tjeret-lirohen-nga-akuzat-ne-rastin-e-njohur-kek-2/?fbclid=IwAR06nE2ng3r97SL-B6bnëRDt8rPpLBT_a-DiTjEyfn21xuT57RyIT3KQAHQ).

dëmshme” dhe i pandehuri i fundit, Azem Duraku për veprën penale “shtytje për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit”. Prokuroria pretendon se sjellja e paligjshme e të pandehurve të lartcekur, ka rezultuar me dhënien e kontratës kompanisë së sigurimit “Security Code”, e cila ka ofertuar si pjesë e konsorciumit me kompaninë “WDG”. Kontrata në fjalë ishte për periudhën dy vjeçare, në shumë prej 6,182,609.76 euro, shumë kjo për të cilën pretendohet se është dëmtuar KEK-u. Në shkallë të parë ky proces përfunduar me aktgjykim lirues, ndërsa po vazhdon më shqyrtimin e ankesave në Gjykatën e Apelit.

- Gjykata Themelore në Mitrovicë, në mungesë të provave ka shpallur aktgjykim lirues ndaj ish-menaxherit të zyrës së prokurimit në spitalin “Sheik Zayed”, në Vushtrri, Mujë Ferati, i akuzuar për keqpërdorim të pozitës zyrtare. Prokuroria Themelore në Mitrovicë, më 24 gusht 2017, kishte ngritur aktakuzë⁷⁴ ndaj Mujë Ferati, të cilin e ngarkon me veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, nga neni 422 par 1 të KPRK-së. Sipas aktakuzës, i pandehuri Ferati, në cilësinë e menaxherit të zyrës së prokurimit të spitalit “Sheikh Zayed”, në Komunën e Vushtrrisë, kishte vepruar në kundërshtim me Udhëzimin Operativ neni T dhe V për Prokurim Publik, të vitit 2013, operatorit ekonomik OE “Kosova Med” nga Prishtina, si fitues i tenderit “Furnizim me pajisje mjekësore”, sipas kontratës që ishte lidhur në mes autoritetit kontraktues – të cilën e kishte nënshkruar i pandehuri Ferati dhe operatorit ekonomik, të cilën e kishte nënshkruar nga drejtori menaxhues i “Kosova Med”, Kastriot Asllani. Siç thuhet në aktakuzë, operatori ekonomik “Kosova Med”, kishte vonuar tetë ditë në dorëzimin e mallit ndaj autoritetit kontraktues spitalit “Sheikh Zayed”, ndërsa i pandehuri nuk kishte ndërmarr masa ndëshkuese për likuidimin e dëmeve – shqiptim i penaltive duke e dëmtuar kështu buxhetin e këtij institucioni në shumë prej 1,187.60 euro.
- Gjykata e Apelit e ka liruar përfundimisht nga akuza për keqpërdorim të detyrës zyrtare, udhëheqësen e Zyrës së Prokurimit në Spitalin Rajonal “Dr. Sami Haxhibeqiri”, në Mitrovicë, Zylfije Halilin. Kështu, gjykata e shkallës së dytë e ka vërtetuar aktgjykimin lirues që Gjykata Themelore në Mitrovicë, e kishte marrë ndaj Halilit, më 1 mars të këtij viti. Udhëheqësja e Zyrës së Prokurimit në Spitalin Rajonal “Dr. Sami Haxhibeqiri”, në Mitrovicë, Zylfije Halili e akuzuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Sipas aktakuzës⁷⁵ së Prokurorisë Themelore në

⁷⁴ “Ish-menaxheri i prokurimit në Spitalin e Vushtrrisë lirohet nga akuza për keqpërdorim detyre”. “Betimi për Drejtësi”. Publikuar më 9 tetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-menaxheri-i-prokurimit-ne-spitalin-e-vushtrrise-lirohet-nga-akuza-per-keqperdorim-detyre/>).

⁷⁵ “Apeli vërteton pafajësinë e udhëheqëses së prokurimit në Spitalin e Mitrovicës lidhur me tenderin për mirëmbajtjen e veturave”. “Betimi për Drejtësi”. Publikuar më 21 gusht 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-pafajesine-e-udheheqeses-se-prokurimit-ne-spitalin-e-mitrovices-lidhur-me-tenderin-per-mirembajtjen-e-veturave/>).

Mitrovicë, të ngritur më 17 dhjetor 2017, Zylfije Halili, po akuzohej se në pozitën e udhëheqëses së Zyrës së Prokurimit në Spitalin Rajonal në “Dr. Sami Haxhibeqiri” në Mitrovicë, duke shfrytëzuar pozitën dhe autoritetin zyrtar nuk i ka përmbushur detyrat zyrtare me qëllim që të përfitoj dobi personi tjetër. Bazuar në aktakuzë, vepra penale është kryer në atë mënyrë që lidhur me tenderin “Mirëmbajtja e dhe servisimi i automjeteve për nevojat e Spitalit Rajonal në Mitrovicë, të shpallur më 6 mars 2014, e akuzuara ka shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik AS “Geni Auto” në Mitrovicë, ku thuhet se ky operator ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta për disa pjesë të caktuara të veturave dhe përkundër kësaj, sipas aktakuzës, e akuzuara Halili, nuk ka kërkuar sqarime shtesë sipas Ligjit të Prokurimit Publik dhe më 2 qershor 2014 ka lidhur kontratën me operatorin e lartcekur ku dhe ka nënshkruar e akuzuara Zylfije Halili. Me këtë, Halili po akuzohet se ka kryer veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422, paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

- Gjykata Themelore në Prishtinë, të hënën, ka shpallur aktgjykim lirues ndaj ish-zyrtarit të prokurimit në kuadër të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Shaip Gashi, të cilin aktakuza e ngarkonte për veprën penale “shpërdorim i pozitës apo autorizimit”. Kryetari i trupit gjykues, Vesel Ismajli, ka bërë të ditur gjatë shpalljes së aktgjykimit se Shaip Gashi lirohet nga akuza pasi nuk është provuar se ai e ka kryer veprën penale që i vihej në barrë.

Prokuroria Themelore në Prishtinë kishte ngritur aktakuzë⁷⁶ më 13 qershor 2016 ndaj Shaip Gashit me pretendimin se i njëjti kishte kryer veprën penale “shpërdorim i pozitës apo autorizimit”, nga neni 422, paragrafi 1 i KPK-së. Në bazë të aktakuzës, Gashi më 29 tetor 2009, në cilësinë e zyrtarit të prokurimit në kuadër të Sekretariatit të KGJK-së, me qëllim që t'i sjell vetes apo dikujt tjetër dobi pasurore kishte keqpërdorur pozitën e tij. Gashi pretendohet se kishte nënshkruar kontratë me operatorin ekonomik “Autoteknik Baholli” edhe pse ky operator nuk ka qenë i përgjegjshëm pasi që në ritenderim ishte kërkuar vetura me fuqi motorike “77-85 kf”, ndërsa tenderi i është dhënë kompanisë “Baholli”, i cili kishte ofruar vetura me fuqi prej “74-100 kf”. Sipas aktakuzës, Gashi kishte vepruar në kundërshtim me mendimin e ekspertit Agim Fejzullahu me ç’rast i kishte mundësuar operatorit “Baholli” të përfitonte në mënyrë të kundërligjshme shumë prej 223,222 euro.

- Gjykata e Apelit e ka liruar përfundimisht nga akuzat për keqpërdorim të pozitës zyrtare, ish-zyrtarin e prokurimit në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave (KRM) “Pastërtia” në Ferizaj, Ilir Beqiri. Kështu, Apeli ka refuzuar ankesën e Prokurorisë

⁷⁶ “Ish-zyrtari i prokurimit në KGJK lirohet nga akuza për korrupsion”. “Betimi për Drejtësi”. Publikuar më 21 janar 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-zyrtari-i-prokurimit-ne-kgjk-lirohet-nga-akuza-per-korrupsion/>).

Themelore në Ferizaj, e cila kishte kërkuar që Beqiri të shpallej fajtor apo që lënda të kthehej në rigjykim. Gjykata Themelore në Ferizaj, më 25 shtator të vitit të kaluar, në mungesë të provave, kishte shpallur aktgjykim lirues ndaj Ilir Beqirit.

Ndryshe, ky rast ka qenë dy herë i kthyer në rigjykim dhe në të janë akuzuar edhe Agim Rexhepi, dhe tre anëtarët e komisionit të vlerësimit të tenderit, Bejtush Mustafa, Ekrem Matoshi e Xhevdet Jakupi. Në gjykimin e parë, i akuzuari Ilir Beqiri dhe Agim Rexhepi, më 6 prill 2015, ishin shpallur fajtorë dhe ishin dënuar me gjashtë muaj burgim efektiv si dhe ishin obliguar që Ministrisë së Financave t'ia kthenin shumën prej 4,500 euro, në emër të dëmit të shkaktuar. Ndërsa, tre anëtarët e komisionit të vlerësimit të akuzuar për veprën “falsifikim i dokumenteve zyrtare”, Ekrem Matoshi, ishte dënuar me pesë muaj burgim, Bejtush Mustafa dhe Xhevdet Jakupi, ishin dënuar me nga katër muaj, dënime që nuk do të ekzekutoheshin në kohëzgjatje prej dy vjetësh, nëse nuk do të kryenin ndonjë vepër tjetër penale. Mirëpo, me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, më 9 tetor 2015, ishte refuzuar akuza vetëm ndaj tre zyrtarëve të komisionit, Ekrem Matoshi, Bejtush Mustafa e Xhevdet Jakupin me arsyetimin për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, konform dispozitës 363 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPP-së. Ndërsa, ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve Agim Rexhepi dhe Ilir Beqiri, ishin aprovuar si të bazuara sepse sipas tyre kishte shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe çështja i ishte kthyer gjykatës në shkallën e parë në rigjykim. Kurse, në gjykimin e dytë prokurori i rastit, Rasim Maloku, e kishte bërë rikualifikimin e veprës penale nga shpërdorim i pozitës zyrtare në keqpërdorim të pozitës zyrtare. Në aktgjykimin e dytë të Gjykatës Themelore në Ferizaj, më 26 qershor 2016, ishte shpall fajtor vetëm i akuzuari Ilir Beqiri, duke u dënuar me gjashtë muaj burgim me kusht dhe me 9000 euro në emër të dëmit të shkaktuar të dëmtuarës Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, ndërsa ishte liruar nga akuza ushtruesi i detyrës së drejtorit në KRM “Pastërtia” në Ferizaj, Agim Rexhepi, për veprën “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, me arsyetimin se ai nuk ka qenë i njoftuar nga shefi i prokurimit që kontrata e tenderimit nuk mund të nënshkruhet nga ana e të akuzuarit si UD i drejtorit, e se po ashtu nuk ka pas njohuri që zyrtari i prokurimit të ketë bërë njoftimin për anulimin e tenderit në fjalë. Mirëpo, me ankesë të palës mbrojtëse, Gjykata e Apelit e Republikës së Kosovës, më 4 tetor të vitit 2016, sërish e kishte kthyer lëndën në rigjykim dhe rivendosje. Ndërkohë, aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, ishte ngritur më 16 korrik 2012, e akuzon Ilir Beqirin se si zyrtar i prokurimit publik, në tenderin e shpallur nga KRM “Pastërtia”, në Ferizaj, për furnizim me mekanizëm të nevojshëm, ka keqpërdorur detyrën zyrtare duke mos vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit të Prokurimit

Publik (LPP). Sipas aktakuzës,⁷⁷ i pandehuri veprën penale e ka kryer në atë mënyrë që pasi ka vërejtur parregullsitë e komisionit vlerësues të ofertave të operatorëve ekonomikë në tenderin në fjalë, e i cili komision kishte propozuar lidhjen e kontratës me NTP “Exim Shped” që nuk plotësonte kriteret e përcaktuara sipas tenderit, dhe pas nënshkrimit të kontratës nga ushtruesi i detyrës së drejtorit me këtë operator, në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, nuk ka njoftuar komisionin rregullativ të prokurimit publik për këto parregullsi, duke dëmtuar buxhetin e Kosovës në shumë prej 9,000 euro.

⁷⁷ “Në herën e tretë, Apeli e liron përfundimisht nga akuzat për korrupsion ish-zyrtarin e prokurimit në KRM “Pastërtia””. “Betimi për Drejtësi”. Publikuar më 21 janar 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ne-heren-e-trete-apeli-e-liron-perfundimisht-nga-akuzat-per-korrupsion-ish-zyrtarin-e-prokurimit-ne-krm-pastertia/>).

Konkluzione

INPO në vazhdim përmbledhë konkluzionet e këtij raporti të monitorimit dhe hulumtimit në lidhje me aktivitetet e prokurimit publik, menaxhimit të zbatimit të kontratave publike si dhe me trajtimin e rasteve të zyrtarëve të akuzuar për korrupsion në prokurim publik nga organet gjyqësore.

- Legjislacioni në fuqi përse i përket fushës së prokurimit publik përmbushë standardet e pranueshme për të zhvilluar aktivitetet e prokurimit publik duke u bazuar në parimet e qeverisjes së mirë, të cilat bazohen në parimin e transparencës, llogaridhënës, mos-diskriminimit, integritetit etj. Përgjithësisht, këto parime në prokurimin publik mundësojnë ruajtjen e vlerës së parasë publike, konkurrencën e lirë, transparencën si dhe trajtimin e barabartë. INPO vlerëson se legjislacioni në këtë fushë, gjithnjë duhet të avancohet në përputhje me zhvillimet e kohës, me theks të veçantë konstaton se ka nevojë të avancohet korniza ligjore, e cila rregullon çështjen e menaxhimit të kontratave publike, fushë kjo, në të cilën ka probleme të cilat karakterizohen si dukuri.
- Komunat e Republikës së Kosovës kanë probleme serioze në planifikimin e vlerave të kontratave publike. Komunat vazhdimisht zhvillojnë aktivitete të prokurimit publik, të cilat rezultojnë me lidhjen e kontratave publike, të cilat tejkalojnë vlerat e shumave të planifikuara me buxhetin komunal. Rrjedhimisht, ky fenomen, ka ndikuar që Komunat të ndërtojnë praktika të këqija të qeverisjes, të cilat përveçse prodhojnë borxhe të komunës, rezultojnë me mungesë të realizimit të punëve në zbatimin e obligimeve të kontratave të lidhura me operatorë të ndryshëm ekonomik. Këta të fundit, duke u përballur me vonesa të pagesave të mjeteve financiare për punët apo shërbimet e kryera, vazhdimisht zvarrisin punimet ose shërbimet, të cilat shkaktojnë dëm në interesin publik të komunës.
- Zyrtarët e prokurimit publik nëpër komuna, në shumë raste të monitoruara, veprojnë në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik sa i përket afateve për tenderim, të cilat i shkurtojnë pa ofruar arsye të qëndrueshme, siç kërkohet me ligj.
- Zyrtarët e prokurimit publik, aplikojnë kritere kufizuese/diskriminuese, të cilat krijojnë pabarazi në mes të operatorëve ekonomikë të interesuar për tenderim. INPO ka gjetur se ndër kufizimet më të shpeshta janë kufizimi i numrit projekteve si dëshmi për kapacitet teknik dhe profesional, kufizimi i numrit të punëtorëve që duhet dëshmuar me lista nga Administrata Tatimore e Kosovës, kërkesat për ISO standarde jo relevante apo të cilat janë të shfuqizuara, dëshmitë se nuk kanë obligime të pashlyera ndaj komunës apo edhe rastet kur operatorët ekonomik që

kanë kontrata të papërfunduara me komunën kufizohen të aplikojnë në tenderë. Këto veprime të zyrtarëve të prokurimit publik mund të prodhojnë pasoja të pariparueshme për operatorët ekonomikë, duke i dëmtuar në pjesëmarrje të tenderëve publikë, duke krijuar në këtë formë terren favorizues për operatorë të caktuar ekonomik, rrjedhimisht duke ofruar mundësi reale për zhvillimin e veprimtarive korruptive.

- Njoftimet e publikuara rreth aktiviteteve të prokurimit publik në shumicën e rasteve publikohen me gabime përmbajtësore dhe teknike, të cilat cenojnë integritetin e procesit të prokurimit publik. Në këtë drejtim, janë shpeshtuar rastet kur zyrtarët e prokurimit, obligohen të përmirësojnë gabimet në njoftimet e publikuara. Shqetësues është fakti se këto përmirësime të gabimeve bëhen në kundërshtim me afatet ligjore dhe ndryshojnë në esencë kriteret e tenderëve të caktuar. Në raste të caktuara, komunat përmes këtyre veprimeve në kundërshtim me ligjin, vështirësojnë qasjen e barabartë të operatorëve ekonomik në tenderë të caktuar, pasi ndodhë që përmirësimet në njoftimet e aktiviteteve të prokurimit publik të bëhen edhe në ditën kur përfundon afati për tenderim. Prapa këtyre veprimeve të kundërligjshme ngriten dyshime të arsyeshme se këto përmirësime në këtë mënyrë bëhen me qëllime të caktuara për të eliminuar apo favorizuar operatorë të caktuar ekonomik.
- Zyrat e Prokurimit Publik në Komuna në raste të caktuara shkelin afatet ligjore për vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve. INPO ka identifikuar disa tenderë, të cilët nuk kanë qenë për nga natyra tender kompleks dhe në të cilat komunat kanë shkelur afatet ligjore për vlerësimin dhe krahasim të tenderëve, përkatësisht komunave iu janë nevojitur mbi 40 ditë për këto procese, ndërsa ligji përcakton se ato duhet të përfundohen brenda 30 ditëve, me përjashtim të tenderëve kompleks, për të cilët mund të zgjatet ky afat.
- Fenomeni i shkeljes së Ligjit të Prokurimit Publik rezulton të jetë kontrata pa afatet e sakta se kur duhet të fillojnë dhe mbarojnë obligimet kontraktuale, respektivisht data e përfundimit të kontratës. Komunat kanë ndërtuar një praktikë të kundërligjshme të lidhjes së kontratave publike me operatorët ekonomikë, duke përcaktuar kohëzgjatjen e kontratës me ditë pune/kalendarike ose muaj dhe jo me data të fillimit dhe mbarimit të kontratës.
- Fenomen tjetër i kundërligjshëm i lidhjes së kontratave publike me operatorët ekonomikë është periudha e validitetit të sigurisë së ekzekutimit të kontratës. Në shumicën e tenderëve të monitoruar, rezulton se validiteti i këtyre sigurimeve është në kundërshtim me ligjin, pasi që afatet e këtyre sigurimeve del se janë më të shkurta sesa kërkohen me ligj apo del se ato skadojnë para përfundimit të

kontratave. INPO gjen se ky fenomen ndodhë edhe si pasojë e mos përcaktimit adekuat të kohëzgjatjes së kontratës.

- Komunat në aktivitete të caktuara të prokurimit publik kushtëzojnë operatorët ekonomik me punësimin e ish-punëtorëve të komunave. Gjetjet e monitorimit tregojnë se këto kushtëzime janë bërë ndaj operatorëve ekonomikë në Gjilan dhe Ferizaj, lidhur me kontratat e pastrimit. Këto kushtëzime janë në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik, i cili në asnjë formë nuk lejon kushtëzime të kësaj natyre.
- Organi Shqyrtues i Prokurimit apo Gjykata e Tenderëve siç njihet në publik në raste të monitoruara nga INPO është anashkaluar nga një Komunë e caktuar, e cila edhe pse ka pasur procedura të hapura në këtë gjykatë, ka vendosur të nënshkruajë kontratë me operatorin e caktuar ekonomik, pa pritur verdiktin përfundimtar. Kjo mënyrë e veprimit të është e kundërligjshme dhe në këto raste mospërfillja e vendimeve të OSHP-së mund të prodhojë pasoja për Komunën.
- Ligji për Prokurimin Publik në fuqi i njeh OJQ-të si operatorë ekonomik, mirëpo në nenin 132/A të këtij ligji, përcaktohet se Qeveria me akt nënligjor përcakton rregullat, standardet dhe procedurat e kontraktimit të shërbimeve publike për organizatat e shoqërisë civile. INPO ka gjetur se në Kosovë nuk ka legjislacion adekuat, i cili rregullon standardet dhe procedurat për kontraktimin e OJQ-ve për ofrimin e shërbimeve publike nga ana e komunave, ministrive, apo agjencive të pavarura. Qeveria deri më tash nuk ka nxjerrë ndonjë akt nënligjor, i cili rregullon këtë fushë. INPO ka gjetur se disa komuna tanimë kanë lidhur kontrata për shërbime me OJQ në vlera të majme monetare, përmes instrumentit të prokurimit publik. Në kuadër të monitorimit, janë hulumtuar katër (4) aktivitete të prokurimit, të cilat kanë rezultuar me lidhjen e kontratave publike për shërbime me OJQ, të cilat ofrojnë shërbime shëndetësore. Në asnjërin nga këto aktivitete të prokurimit nuk është shënuar se kontraktimi i shërbimeve është planifikuar të bëhet nga OJQ-të.

INPO shpreh shqetësim në lidhje me kontraktimin e këtyre shërbimeve nga OJQ-ja, e cila nuk ka ofruar dëshmi se i ka plotësuar të gjitha kriteret ligjore, duke përfshirë licensën për ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe dëshmitë e tjera të stafit mjekësorë.

INPO vlerëson se komunat respektive gjatë udhëheqjes së procedurave për të kontraktuar shërbime mjekësore dhe ambulatore nga OJQ-të kanë vepruar në kundërshtim me bazën ligjore. Në bazë të hulumtimit, INPO ngritë dyshime se këto kontrata janë shfrytëzuar për të punësuar staf shëndetësorë në Qendrat e Mjekësisë Familjare të Komunave.

- Sistemi i drejtësisë përmes veprimeve dhe vendimeve adekuate duhet të arrijë qëllimin për të ndjekur dhe gjykuar në mënyrë të drejtë dhe të bazuar në ligj, të gjithë zyrtarët e përfshirë në kryerjen e veprave penale që ndërlidhen me prokurimin publik. Gjatë këtij viti, janë monitoruar 23 seanca gjyqësore, ku përfshihen nëntë (9) lëndë në të cilat akuzohen për korrupsion zyrtarët e prokurimit publik të nivelit të institucioneve lokale dhe qendrore. Karakteristikë e këtyre rasteve është se gjatë këtij viti, gjykatësit kanë shpallur aktgjykime liruese në pesë (5) raste, ndërsa në katër (4) rastet e tjera po vazhdojnë shqyrtimet gjyqësore. Pra, ende nuk ka asnjë zyrtarë të prokurimit publik të akuzuar për korrupsion dhe të dënuar me burgim efektiv gjatë këtij viti.

Gjetjet tregojnë se në nivelin komunal në lidhje me kryerjen e veprave penale në fushën e prokurimit publik gjatë këtij viti janë duke u përballur me procedura gjyqësore Drejtori i Zyrës së Prokurimit në Gjilan, Lipjan dhe Prizren si dhe Kryetari i Komunës së Istogut, Haki Rugova. Ky i fundit, akuzohet se ia ka dhënë tenderin vëllait të tij, duke ia mundësuar dhënien e kontratës përmes procedurave të prokurimit publik, kontratë kjo, të cilën e kishte nënshkruar personalisht.

Pa paragjykuar epilogun e këtyre rasteve gjyqësore, në përgjithësi rezulton se politika e ndjekjes dhe dënimeve në këto raste nuk është adekuate, rrjedhimisht nuk arrihet qëllimi për të ndëshkuar të përfshirët në afera korruptive dhe që të parandalohen veprimet e njëjta nga zyrtarët e tjerë.

Rekomandime

INPO në vazhdim ofron rekomandime konkrete me qëllim që të sigurohet integritet në zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit publik në mënyrë që paraja publike të shpenzohet në mënyrë racionale, duke respektuar në plotni kriteret ligjore dhe standardet e qeverisjes së mirë.

- Në procesin aktual të analizimit të kornizës ligjore në fushën e prokurimit publik, rekomandohet që të adresohet në mënyrë më specifike çështja e rregullimit të obligimeve që ndërlidhen me menaxhimin e kontratave publike, fushë kjo, në të cilën ka probleme të cilat karakterizohen si dukuri.
- Komunat e Republikës së Kosovës duhet të zbatojnë obligimet ligjore lidhur me planifikimin e buxhetit komunal, duke mos planifikuar projekte apo shërbime, të cilat nuk ka buxhet që t'i mbulojë. Në këtë drejtim, zyrtarët e prokurimit publikë, në asnjë rast nuk duhet të ndërmarrin veprime për të iniciuar procedura të prokurimit për të cilat nuk dëshmohet se ka mjete të mjaftueshme financiare për realizimin e projekteve apo shërbimeve të caktuara. Në të kundërtën, nëse vazhdohet me këso shkelje ligjore nga zyrtarët e prokurimit publik, duke lidhur kontrata publike, pa pasur buxhet të mjaftueshëm apo duke e zhytur komunën në borxhe, atëherë kjo përbën alarm për organet e ndjekjes, të cilat duhet të veprojnë për të ruajtur interesin publik, rrjedhimisht për të ruajtur buxhetin e taksapaguesve.
- Kryetarët e Komunave duhet të rrisin transparencën, mbikëqyrjen dhe llogaridhënien e zyrtarëve të prokurimit publik, të cilët haptas veprojnë në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik sa i përket afateve për tenderim, aplikimin e kriterëve kufizuese/diskriminuese dhe të tjera veprime që e cenojnë në çfarëdo forme integritetin e proceseve të prokurimit publik.
- Në përputhje me të drejtat që Ligji për Prokurimin Publik ua njeh OJQ-ve që si operatorë ekonomik, të ofrojnë shërbime të ndryshme, Qeveria e Republikës së Kosovës, duhet të përmbushë obligimet ligjore për të miratuar legjislacionin sekondar përmes të cilit do të përcakton qartë rregullat, standardet dhe procedurat e kontraktimit të shërbimeve publike për organizatat e shoqërisë civile.
- Hetuesit policorë të krimeve ekonomike, prokurorët dhe gjykatësit duhet të profilizohen në fushën e prokurimit publik, për të mundësuar hetime, ndjekje dhe gjykime profesionale për të zbardhur aktivitetet kriminale të cilat zhvillohen përmes prokurimit publik. Politika e ndjekjes duhet të avancohet për të zhvilluar hetime të drejta dhe të bazuara në ligj, sikurse gjykatësit duhet të gjykojnë drejtë

këto raste dhe në rastet kur gjejnë fajtor të akuzuarit në fushën e prokurimit publik të shqiptojnë dënime adekuate përmes të cilave arrihet qëllimi i dënimit.

Rreth INPO

Iniciativa për Progres (INPO) është organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e themeluar në vitin 2005 me qëllim që të përparoj pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset shoqërore, përmes së cilës avokohet për çështje shoqërore, politike, ekonomike, forcimin e parimit të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike, rritjen e kërkesave të qytetarëve si dhe luftimin e korrupsionit, duke synuar në promovimin e vlerave të një shoqërie të hapur dhe demokratike.

Vizioni i Organizatës INPO është për institucione lokale që qeverisen me vlera demokratike ku qytetari është bashkëvendimmarrës, ndërsa INPO për mision ka promovimin e demokratizimit të qeverisjes lokale përmes aktivizmit qytetar dhe përkushtohet në avansimin e vlerave të një shoqërie të hapur.

Vizioni dhe misioni i Organizatës INPO përmbushen përmes aktiviteteve të ndryshme të punës të cilat organizohen nga dy (2) programet e specializuara të Organizatës: (i) Programi për Qeverisje të Mirë, dhe (ii) Programi për Zhvillim Demokratik. Ky dokument është produkt i Programit për Qeverisje të Mirë, program i cili ka për qëllim promovimin e qeverisjes së përgjegjshme duke nxitur përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje, transparencë, llogaridhënie dhe sundim të ligjit.

INPO që nga themelimi ka shtyrë përpara agjendat për më shumë transparencë në shpenzimet financiare publike, përfshirjen më të mirë dhe më të gjerë të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes publike dhe rritjen e llogaridhënies së zyrtarëve publik të ndjeshëm ndaj korrupsionit dhe sjelljeve të tjera të këqija në institucionet publike.

Shtojcë: Aktivitetet e prokurimit të monitoruara

Nr.	Autoriteti kontraktues	Titulli i aktivitetit të prokurimit	Lloji i aktivitetit të prokurimit	Lloji i procedurës së prokurimit	Vlera e aktivitetit të prokurimit
1	Komuna e Deçanit	Ndërtimi-Zgjerimi i rrugës R107 qendrore në Deçan (Ura e Demës-Carrabreg)	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e madhe
2	Komuna e Deçanit	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Irzniq	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
3	Komuna e Dragashit	Ndërtimi i murit mbrojtës dhe infrastrukturës përcjellëse në fshatin Buçe	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
4	Komuna e Dragashit	Furnizimin me pajisje kompjuterike (kompjuter, laptop, monitor, shtëpiza, UPS, printer, skaner etj.	Furnizim	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
5	Komuna e Ferizajt	Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike objektit të Komunës së Ferizajt, dhe institucioneve tjera që funksionojnë në kuadër të Komunës së Ferizajt	Shërbime	Procedura e hapur	Vlerë e madhe
6	Komuna e Ferizajt	Sigurimi fizik i objektit të komunës dhe objekteve të tjera të cilat funksionojnë në kuadër të Komunës së Ferizajt	Shërbime	Procedura e hapur	Vlerë e madhe

7	Komuna e Ferizajt	Administrimi i profilit të kryetarit të komunës në rrjete sociale			
8	Komuna e Fushë Kosovës	Dezinsektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve arsimore, shëndetësore dhe hapësirave publike	Shërbime	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
9	Komuna e Fushë Kosovës	Furnizim me gjëra ushqimore dhe mjete sanitare	Furnizim	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
10	Komuna e Gjakovës	Ndërtimi i rrugës Cermjan-Meqe-kontratë tri vjeçare	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e madhe
11	Komuna e Gjakovës	Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës	Shërbime	Procedura e hapur	Vlerë e madhe
12	Komuna e Gjilanit	Shërbime profesionale për QKMF dhe Administratën Komunale	Shërbime	Procedura e hapur	Vlerë e madhe
13	Komuna e Gjilanit	Pastrimi i objekteve komunale në Gjilan	Shërbime	Procedura e hapur	Vlerë e madhe
14	Komuna e Gjilanit	Pastrimi i objekteve Komunale në Gjilan	Shërbime	Procedura e hapur	Vlerë e madhe
15	Komuna e Glogocit	Intervenimet emergjente në Komunën e Drenasit	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
16	Komuna e Glogocit	Furnizim me artikuj higjienik për nevojat e institucioneve komunale - administratës, arsimit dhe shëndetësisë	Furnizim	Procedura e hapur	Vlerë e mesme

17	Komuna e Graçanicës	Instalimi i nxemjes qendrore në institucionet arsimore - Ritender	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
18	Komuna e Graçanicës	Shërbimet e përkthimit nga serbishtja në shqip dhe anasjelltas	Shërbime	Me kuotim të çmimeve	Vlerë e vogël
19	Komuna e Hanit të Elezit	Furnizim me autoambulancë	Furnizim	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
20	Komuna e Hanit të Elezit	Shtrimi me kubëza në zonat rurale dhe urbane - sipas LOT-eve	Shërbime	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
21	Komuna e Istogut	Furnizim me artikuj pastrimi dhe higjienike	Furnizim	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
22	Komuna e Istogut	Furnizimi me artikuj ushqimor për nevoja të institucioneve komunale	Furnizim	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
23	Komuna e Junikut	Hapja e rrugëve fushore në Komunën e Junikut	Shërbime	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
24	Komuna e Junikut	Mirëmbajtja dhe servisimi i pajisjeve mjekësore	Shërbime	Me kuotim të çmimeve	Vlerë e vogël
25	Komuna e Kaçanikut	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve të qytetit	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
26	Komuna e Kaçanikut	Furnizim me material ushqimor dhe pije	Furnizim	Me kuotim të çmimeve	Vlerë e vogël
27	Komuna e Kamenicës	Furnizim me material laboratorik dhe reagensa dhe material stomatologjik	Furnizim	Procedura e hapur	Vlerë e mesme

28	Komuna e Kamenicës	Shërbime të DDD-së	Shërbime	Me kuotim të çmimeve	Vlerë e vogël
29	Komuna e Klinës	Asfaltimi i rrugëve Lot 1- rrugëve lokale Budisalc, Lot-2 rrugëve lokale Stup, Lot 3- rrugëve lokale Siqevë, Lot 4rrugëve lokale Qeskov, Lot 5 - rrugëve lokale Gjurgjeviki i vogël	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
30	Komuna e Klinës	Asfaltimi i rrugës Dollove, Grabanicë, Dush, Jelloc	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
31	Komuna e Klinës	Ndërtimi i kanalizimeve LOT 1- në Ranoc, Leskoc faza 1, LOT 2- Dresnik faza 1, LOT 3- Dollc faza 1, LOT 4 - në lagje të Klinës	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
32	Komuna e Klokotit	Furnizim me shenja të komunikacionit vertikale, horizontale si dhe panelet me ndriçim	Punë	Me kuotim të çmimeve	Vlerë e vogël
33	Komuna e Klokotit	Rikonstruktimi dhe zgjerimi i ndriçimit publik për Komunën e Klokotit	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
34	Komuna e Leposaviqit	Rindërtimi dhe ndërtimi i rrugëve hyrëse në territorin e komunës së Leposaviqit	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e mesme

35	Komuna e Leposaviqit	Ndërtimi i ndriçimit rrugor në komunën e Leposaviqit	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
36	Komuna e Lipjanit	Furnizimi me material higjienik për institucionet arsimore, shëndetësore, shërbimin e zjarrfikjes dhe shpëtimit dhe shtëpinë e komuniteteve - kontratë kornizë- Rindërtim	Furnizim	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
37	Komuna e Lipjanit	Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve të institucioneve komunale	Shërbime	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
38	Komuna e Malishevës	Furnizim me ushqim dhe pije për nevojat e institucionit parashkollor, çerdhes publike Zërat e Ëmbël në Malishevë	Furnizim	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
39	Komuna e Malishevës	Renovimi i objekteve shkollore, çerdhes publike dhe sallës së sportit të Komunës së Malishevës	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
40	Komuna e Mamushës	Servisimi, mirëmbajtja, dhe riparimi i automjeteve zyrtare të Komunës së Mamushës	Shërbime	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
41	Komuna e Mamushës	Furnizimi me material shpenzues higjienik dhe pajisje	Furnizim	Me kuotim të çmimeve	Vlerë e vogël

42	Komuna e Mitrovicës së Jugut	Furnizimi, vendosja dhe montimi i semaforëve dhe mirëmbajtja 3 (tri) vjeçare e semaforëve	Furnizim	Procedura e hapur	Vlerë e madhe
43	Komuna e Mitrovicës së Jugut	Ndërtimi dhe vendosja e shkallëve emergjente në disa objekte shkollore	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
44	Komuna e Mitrovicës së Veriut	Blerje e karrigeve për nevoja të odës së shkollës teknike të mesme	Furnizim	Me kuotim të çmimeve	Vlerë e vogël
45	Komuna e Mitrovicës së Veriut	Furnizim me teknika e bardhë për nevojat e shkollës parashkollore Danica Jaramaz	Furnizim	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
46	Komuna e Novobërdës	Ndërtimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik në Komunën e Novobërdës	Furnizim	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
47	Komuna e Novobërdës	Furnizim me mekanizëm bujqësor dhe multikultivator për subvencionim të fermerëve 2019-2020	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
48	Komuna e Obiliqit	Furnizim me gjëra ushqimore për çerdhe dhe institucione tjera komunale	Furnizim	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
49	Komuna e Obiliqit	Sigurimi fizik i objektit komunal	Shërbime	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
50	Komuna e Parteshit	Punimet e kulmit me llamarinë në shkollën fillore Pasjan	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e mesme

51	Komuna e Parteshit	Furnizim me pajisje bujqësore	Furnizim	Me kuotim të çmimeve	Vlerë e vogël
52	Komuna e Pejës	Rregullimi i qendrës së qytetit- Ndërtimi i sheshit Nëna Terezë në Pejë	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e madhe
53	Komuna e Pejës	Ndërtimi i shkollës së Artit Faza II	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e madhe
54	Komuna e Podujevës	Ndërtimi i bulevardit dhe sheshit "Sheshi i Dëshmorëve" në qendër të qytetit	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e madhe
55	Komuna e Podujevës	Ndërtimi i objektit të ri të emergjencës	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e madhe
56	Komuna e Prishtinës	Shërbime të menaxhimit të parkingjeve në Qytetin e Prishtinës	Shërbime	Procedura e negociuar	Vlerë e mesme
57	Komuna e Prishtinës	Ofrimi i shërbimeve të përkthimit	Shërbime	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
58	Komuna e Prishtinës	Ndërtimi parqeve rekreativo- sportive - Renovimi i Kompleksit Qafa	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e madhe
59	Komuna e Prizrenit	Kujdesi socio - shëndetësor shtëpiak dhe ambulator për qytetarët e Komunës së Prizrenit	Shërbime	Procedura e hapur	Vlerë e madhe
60	Komuna e Prizrenit	Ndërtimi i infrastrukturës në parkun ekonomik në Lubizhdë të Prizrenit	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e madhe

61	Komuna e Rahovecit	Furnizim me material higjenik	Furnizim	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
62	Komuna e Rahovecit	Ndërtimi i semaforëve të rinj	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
63	Komuna e Ranillugës	Furnizim me ushqime dhe produkte higjienike	Furnizim	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
64	Komuna e Ranillugës	Ndërtimi i sallës së fiskullturës për shkollën fillore "Trajko Periq" në Ropotovë të Madhe Komuna e Ranillugës	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
65	Komuna e Shtërpcës	Furnizim me material higjenik për nevoja të Komunës së Shtërpcës, nevojat e shkollave dhe mjekësisë familjare në territorin e Komunës së Shtërpcës	Furnizim	Me kuotim të çmimeve	Vlerë e vogël
66	Komuna e Shtërpcës	Ngjyrosja e ndërtesës komunale dhe objektin e ambulancës në Brod	Shërbime	Me kuotim të çmimeve	Vlerë e vogël
67	Komuna e Shtimes	Furnizimi me mirëmbajtje të ndërtesave për institucionet e Komunës së Shtimes	Furnizim	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
68	Komuna e Shtimes	Furnizimi me pajisje tjera për institucionet e Komunës së Shtimes - Ri-Tender	Furnizim	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
69	Komuna e Shtimes	Kujdesi shtëpiak - palativ i të sëmurëve në Komunën e Shtimes	Shërbime	Procedura e hapur	Vlerë e mesme

70	Komuna e Skënderajt	Asfaltimi i rrugës Rudik deri te Kisha	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e madhe
71	Komuna e Skënderajt	Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve të AK	Shërbime	Procedura e hapur	Vlerë e madhe
72	Komuna e Suharekës	Fasadimi i objekteve, renovimi i pullazeve të objekteve publike dhe kolektive - Suharekë	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
73	Komuna e Suharekës	Blerje e pajisjeve mjekësore për QKMF dhe QMF	Furnizim	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
74	Komuna e Suharekës	Shërbime për realizimin e vitalizimi i infrastrukturës për funksionalizimin e projektit shtretërit shtëpiak	Shërbime	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
75	Komuna e Vitisë	Renovimi i ambulanteve	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
76	Komuna e Vitisë	Rivitalizimi i ndërtesës së Komunës së Vitisë	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
77	Komuna e Vushtrrisë	Asfaltimi i rrugëve lokale në qytet	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e madhe
78	Komuna e Vushtrrisë	Shërbime të Deratizimit, Dezinfektimit dhe Dezinsektimit DDD	Shërbime	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
79	Komuna e Zubin Potokut	Ndërtimi i ndriçimit rrugor në vendbanimet e komunës së Zubin Potokut	Punë	Procedura e hapur	Vlerë e mesme

80	Komuna e Zubin Potokut	Prokurimi i pajisjeve të zjarrfikësve për stacionin e zjarrit në Komunën e Zubin Potokut	Furnizim	Me kuotim të çmimeve	Vlerë e vogël
81	Komuna e Zveçanit	Shërbimet e sigurisë fizike të objektit të ZKK	Shërbime	Procedura e hapur	Vlerë e mesme
82	Komuna e Zveçanit	Hartimi i dokumentacionit tekniko-projektues- Projektit kryesor për ndërtimin e rezervuarëve të ujit të pijshëm në Zveçan dhe kryerja e shërbimeve profesionale mbikëqyrëse në realizimin e projektit në fjalë	Shërbime	Procedura e hapur	Vlerë e mesme

Integriteti i proceseve të prokurimit publik në Komunitet e Republikës së Kosovës vazhdon të jetë i cenueshëm. Përkundër faktit se legjislacioni në fuqi në fushën e prokurimit publik përmbushë standardet e pranueshme për të zhvilluar aktivitetet e prokurimit publik duke u bazuar në parimet e qeverisjes së mirë, në praktikë vazhdimisht cenohen këto parime, përfshi transparencën, llogaridhënien, mos-diskriminimin, integritetin etj.

Iniciativa për Progres (INPO) dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) me qëllim që të hartojnë një raport sa më real dhe analitik në lidhje me zbatimin konceptual dhe sipas obligimeve ligjore të cikleve të prokurimit, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit dhe analizës.

Hulumtimi përfshinë monitorimin dhe analizimin e 160 aktiviteteve të prokurimit, respektivisht 80 aktivitete nga inicimi i prokurimit e deri tek lidhja e kontratës dhe 80 aktivitete të menaxhimit të kontratës, në të gjitha komunitet e Republikës së Kosovës. Mesatarisht, secilës komunë i janë monitoruar katër (4) tenderë, dy (2) inicime dhe dy (2) menaxhime të kontratës. Ky monitorim është zhvilluar në periudhën dhjetor 2018 deri në fillim të nëntorit 2019. Monitorimi gjithashtu përfshinë edhe rastet gjyqësore të zyrtarëve të prokurimit apo zyrtarëve të tjerë të akuzuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare në lidhje me prokurimin publik.

Metoda e përzgjedhjes së tenderëve/kontratave për tu analizuar dhe monitoruar është bazuar në indikatorë automatik siç janë: (i) aktiviteti i prokurimit me vetëm një ofertë, (ii) çmimi i kontratës është shumë afër çmimit të parashikimit të vlerës, (iii) rastet e eliminimit të të gjitha ofertave që kanë aplikuar, përveç asaj fituese, (iv) tenderët me afate të shkurtuara, (v) çmimi i ofertës fituese është më i lartë sesa parashikimi i vlerës së kontratës, si dhe sipas rrezikut të sektorit (shtrimi të rrugëve, tenderët e sigurimit fizik, tenderët e pastrimit, furnizimeve, etj). Në disa raste është përdorur edhe metoda e rastësisë në përzgjedhje të tenderit apo kontratës.

www.inpo-ks.org

Iniciativa për Progres është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e themeluar në vitin 2005 me qëllim që të përparoj pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset shoqërore. Organizata INPO funksionon në bazë të programeve të saj: Programi për Qeverisje të Mirë, dhe Programit për Zhvillim Demokratik.

Ky botim është produkt i projektit “Kërko Drejtësi: Fuqizimi i qasjes në drejtësi në Kosovë”, projekti i implementuar nga Organizata INPO dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi me mbështetje financiare të Departamentit të Shtetit Amerikan - Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL)